Gazeta Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXIV i botimit, nr. 276, Tetor 2026

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.al, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 100 lekë / 1 euro

DUKAGJINI, THESARI I PASHFRYTËZUAR I SHQIPËRISË

7

Në zonën e Dukagjinit të Shqipërisë u mbajt manifestimi tradicional "Dita e Rinisë Dukagjinase". Falë kontributit të dhënë për këtë manifestim nga nikoqiri Kolë Gjoni, burr nga zona e Shoshit, ky manifestim u mbajt në mënyrën më dinjitoze dhe perfekte, duke u bërë realitet ideja e këtyre të rinjve dukagjinas.

Këtë manifestim e ndihmuan edhe disa anëtarë të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", të cilët dhanë kontributin e tyre, në krye me Dukate Bregun, Roza Mhill Pjetrin dhe Agron Hasanin. Nën tingujt e bukur të këngëtarëve dukagjinas të mirënjohur, Viola Shqau, Noel Pjetri dhe Gentia Gropa, u realizua në mënyrë madhështore festa dyditore "Dita e Rinisë Dukagjinase". Manifestimi u mbajt në vendin e quajtur Nderlysaj, pikë kyçe e zonës, në restorantin "Veni i Gjyshit".

Dashuria për këto zona, Theth, Shalë dhe Shosh, i bën dukagjinasit unikë dhe të pathyeshëm në komb, fe dhe traditë. Me bashkëfinancimin e Kolë Gjonit dhe disa dukagjinasve, të cilët nuk dëshirojnë t'u përmenden emrat, u mbajt manifestimi madhështor "Dita e Rinisë Dukagjinase".



DUKAGJINI - ATY KU MALET RUAJNË KUJTESËN E SHQIPTARIT

2

Ese nga GJON MARKU / Ka vende që i njeh nga hartat, ka të tjera që i njeh nga librat, por ka edhe vende që, për t'i kuptuar, duhet t'i dëgjosh. Dukagjini është një prej tyre. Ai nuk të shfaqet menjëherë. Të del përpara ngadalë, përmes maleve, grykave, shtigjeve, lumenjve dhe fshatrave të shpërndarë si kujtime të vjetra në faqet e shkëmbinjve. Atje rruga nuk është vetëm rrugë. Është një provë. Lumi nuk është vetëm ujë. Është kujtesë. Kulla nuk është vetëm gur. Është histori. Ndërsa njeriu dukagjinas nuk është vetëm banor i një treve të thellë malore; ai është trashëgimtar i një mënyre jetese që për shekuj u përball me natyrën, varfërinë, pushtimet, izolimin dhe mungesën e shtetit.

NJË PARAJSË E VOGËL KY SHPIRTI GJEN QETSINË

"Shtegtar ndalu në këtë shesh e Lute - Të falem Mari Hirplote. Pusho pak e merre bekimin e Zojës e të Shna Ndout"- Don Vlash Palaj

Në zemër të Shalës, buzë Lumit në krye të Ures, buzë rrugës e afër spitalit një parajsë e vogël ky shpirti gjen qetsinë. Ishte ma parë një Kapel (vend lutje) e Shna Ndout ku koha e frymzuar prej "kjoft-largut" e rrënoj. Në kufirin e harresës, ngallnjeu Drita mbi Terrin. U rikthye truporja e Shna Ndout, pastaj Zoja (Pieta) dhe basorelievi I Kishës tashmë i gllendur në gurë. Sot Zoja u kthye me Krishtin në preher… Nuk e ndaloj Oqeani as koha plot zhurmë Gjin Markaj që sot me zemrën plot ti thotë Zotit e Zojës FALEMINDERIT. Thellë në shpirtin e tij një za buçet- Nanë ta solla Zojën që në çdo vuajtje dhe sakrific ti s'ja ndave syte as lutjet. Gjini së bashku me nanën e tij kujton të gjitha nanat dukagjinase që sakrifikuan dhe falen Dashni në vuajtje si Zojae Bekueme. Me 26 Shtator 2026 në Breg Lumit të Shalës Gjiin Markaj reralizoj ëndrrën e tij të kahershme duke i kushtuar vuajtjes dhe dhimbjes së nënës tij e krejt nënave të Dukagjinit truporen e Zojës me Krishtin në preher "Pieta"me rastin e vitit Jubilare të Nënës së Këshillit t'Mirë.. Gjithashtu sheshi në ballë të Urës së Shalës u kompletua edhe me basorelievin ku ishte gllendur Kisha e Shna Ndot e skaltura nga mjeshtri Zef M[illegible]e struktura metalike m[illegible]ertimin e Kishes ...

8



DUKAGJINI - Aty ku malet ruajnë kujtesën e shqiptarit

Ese nga GJON MARKU

Ka vende që i njeh nga hartat, ka të tjera që i njeh nga librat, por ka edhe vende që, për t'i kuptuar, duhet t'i dëgjosh.

Dukagjini është një prej tyre.

Ai nuk të shfaqet menjëherë. Të del përpara ngadalë, përmes maleve, grykave, shtigjeve, lumenjve dhe fshatrave të shpërndarë si kujtime të vjetra në faqet e shkëmbinjve. Atje rruga nuk është vetëm rrugë. Është një provë. Lumi nuk është vetëm ujë. Është kujtesë. Kulla nuk është vetëm gur. Është histori. Ndërsa njeriu dukagjinas nuk është vetëm banor i një treve të thellë malore; ai është trashëgimtar i një mënyre jetese që për shekuj u përball me natyrën, varfërinë, pushtimet, izolimin dhe mungesën e shtetit.

Dhe ndoshta pikërisht për këtë arsye, kur flasim për Dukagjinin, nuk duhet të flasim vetëm për një krahinë. Duhet të flasim për një pjesë të kujtesës shqiptare.

Fjala "Dukagjin" është shumë më e vjetër dhe më e gjerë sesa kufijtë administrativë që ne njohim sot. Në Mesjetë, familja e Dukagjinëve ishte një nga familjet e rëndësishme fisnike shqiptare dhe zotërimet e saj shtriheshin në hapësira të gjera të Shqipërisë së Veriut dhe deri në Kosovën perëndimore. Lezha ishte një nga qendrat e rëndësishme të tyre, ndërsa në burimet historike përmenden Mirdita edhe Zadrima, Pulti dhe territore të tjera veriore.[1]

Prandaj duhet bërë një dallim i domosdoshëm: Dukagjini historik nuk është i njëjtë me Dukagjinin e sotëm si krahinë malore rreth Shalës, Shoshit, Pultit e trevave përreth.

Emri ka mbijetuar, por hapësirat dhe kuptimet e tij kanë ndryshuar gjatë shekujve. Kjo e bën Dukagjinin edhe më interesant.

Një emër mund të ndryshojë kufij, por nuk e humb domosdoshmërisht kujtesën. Në këtë kuptim, Dukagjini është një prej atyre emrave shqiptarë që kanë kaluar nga historia politike në gjeografinë kulturore të vendit.

Familja e Dukagjinëve lidhet me Mesjetën shqiptare, me princër, zotërime, marrëdhënie me Venedikun, me luftërat kundër osmanëve dhe me historinë e rezistencës shqiptare. Në këtë kontekst shfaqet edhe figura e Lekë Dukagjinit, bashkëkohës i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe një nga figurat më të rëndësishme të aristokracisë shqiptare të shekullit XV.[2]

Por historia e Dukagjinit nuk mbaron me princat. Përkundrazi. Ajo sapo fillon aty. Sepse pas emrave të mëdhenj të historisë vjen një popull që për shekuj e ruajti jetën e vet në male.

Në Dukagjin mali nuk ka qenë dekor. Ka qenë fat. Ka qenë pengesë dhe mbrojtje njëkohësisht. Ka qenë varfëri dhe pasuri. Ka qenë izolim, por edhe liri. Në këtë hapësirë të thyer malore, njeriu duhej të mësonte të jetonte me atë që kishte: një copë tokë, disa bagëti, një shtëpi prej guri, një burim uji, një rrugë të vështirë dhe, mbi të gjitha, njerëzit e vet. Prandaj shoqëria dukagjinase nuk mund të kuptohet pa natyrën.

Mali e mësoi njeriun të ishte i fortë. Terreni e mësoi të ecte gjatë. Dimri e mësoi të ruante ushqimin. Izolimi e mësoi të mbështetej te tjetri. Dhe rreziku e mësoi se fjala duhej të kishte peshë. Kështu u krijua ajo që sot e quajmë **"karakter malësor"**, por që, në të vërtetë, është rezultat i një historie të gjatë shoqërore.



Në Dukagjin, natyra nuk ndahej nga jeta. Ajo ishte vetë jeta.

Nëse do të kërkoje një simbol të Dukagjinit, ndoshta nuk do të duhej të zgjidhje vetëm një mal. Mund të zgjidhje një lumë: lumin e Shalës.

Ai përshkon një prej hapësirave më karakteristike të kësaj treve dhe sot është bërë edhe një nga pamjet më të njohura turistike të veriut shqiptar. Por, për dukagjinasin, lumi nuk ka qenë spektakël turistik. Ka qenë udhë. Ka qenë burim jete. Ka qenë orientim. Ka qenë pjesë e ekonomisë dhe e marrëdhënies së përditshme me natyrën.

Sot, fotografi të shumta të ujërave të kaltra të Shalës qarkullojnë nëpër botë. Turisti sheh bukurinë e ujit, shkëmbinjtë, gjelbërimin dhe malet.

Por ai sheh vetëm sipërfaqen.

Sepse pas asaj bukurie ka një histori njerëzore. Ka njerëz që kanë ecur nëpër këto shtigje kur nuk kishte rrugë automobilistike. Ka gra që kanë mbajtur mbi shpinë barrën e shtëpisë. Ka burra që kanë udhëtuar me ditë për të zgjidhur një hall. Ka fëmijë që kanë shkuar në shkollë nëpër shtigje të vështira. Dhe ka varre njerëzish që kanë jetuar e kanë vdekur pa e parë kurrë botën përtej maleve.

Kjo është ana e Dukagjinit që nuk shihet në fotografitë turistike.

Nëse Shqipëria do të kishte një kartolinë të vetme të Alpeve të saj, Thethi do të ishte ndër kandidatët e parë. Thethi ndodhet në Njësinë Administrative Shalë, në Bashkinë Shkodër, në zemër të Alpeve Shqiptare. Ujëvara e Grunasit, Kanioni i Grunasit, burimet e Okolit dhe mali i Harapit janë vetëm disa prej elementeve që e kanë bërë këtë hapësirë një nga destinacionet më të njohura malore të Shqipërisë.[3]

Por Thethi është më shumë se një peizazh. Është një mënyrë jetese. Kullat, shtëpitë tradicionale, kishat, bujtinat dhe mikpritja krijojnë një tablo ku natyra dhe kultura nuk janë të ndara. Aty ndodh diçka që sot është bërë gjithnjë e më e rrallë: turisti nuk viziton vetëm një vend, por hyn në një histori.

Por kjo histori duhet treguar me kujdes. Sepse ekziston një rrezik i madh. Kur një vend bëhet shumë i famshëm, mund të ndodhë që të fillojë të humbasë atë që e bëri të famshëm. Nëse ndërtojmë pa masë, humbasim peizazhin. Nëse zëvendësojmë arkitekturën tradicionale me ndërtime pa karakter, humbasim identitetin. Nëse mikpritjen e kthejmë vetëm në biznes, humbasim shpirtin. Dhe atëherë mund të kemi turistë, por të mos kemi më Theth.

Kulla dukagjinase është një nga simbolet më të fuqishme të kësaj treve. Ajo është ndërtuar për t'i rezistuar kohës, klimës dhe rrezikut. Por kulla nuk duhet parë vetëm si simbol i luftës. Ajo ishte shtëpi. Aty lindeshin fëmijët. Aty rritej familja. Aty ruheshin ushqimet. Aty pritej miku. Aty merreshin vendime. Aty përcillej historia nga një brez te tjetri.

Në shoqërinë tradicionale shqiptare, shtëpia nuk ishte vetëm pronë private. Ishte qendra e familjes dhe e marrëdhënieve shoqërore. Dhe kulla e Dukagjinit e shfaqte këtë realitet me një forcë të veçantë.

Por këtu duhet të kemi edhe guximin për të thënë një të vërtetë tjetër. Nuk mund ta romantizojmë të kaluarën. Krahas mikpritjes, besës dhe solidaritetit, jeta tradicionale kishte edhe konflikte, gjakmarrje, kufizime shoqërore dhe pabarazi që sot nuk mund të pranohen. Një shoqëri moderne nuk mund të rikthehet te dhuna në emër të traditës. Por mund ta studiojë traditën për të kuptuar se si kanë jetuar paraardhësit tanë. Ky është dallimi midis ruajtjes së kujtesës dhe kthimit pas në kohë.

Dukagjini nuk mund të përmendet pa Kanunin. Por edhe këtu kërkohet maturi.

Kanuni i Lekë Dukagjinit, në formën në të cilën njihet sot, është një përmbledhje e së drejtës zakonore shqiptare të mbledhur dhe sistemuar nga At Shtjefën Gjeçovi në fillim të shekullit XX. Studimet bashkëkohore e trajtojnë këtë material si pjesë të traditës së gjerë të së drejtës zakonore shqiptare, e cila ishte zhvilluar dhe përcjellë gojarisht ndër breza.[4] Pra, nuk është historikisht e saktë ta imagjinojmë Kanunin si një libër që Lekë Dukagjini e shkroi një ditë dhe ua la malësorëve si kod të gatshëm. Emri i tij lidhet me këtë traditë, ndërsa Gjeçovi bëri punën monumentale të mbledhjes, sistemimit dhe dokumentimit. Dhe pikërisht këtu qëndron një nga meritat më të mëdha të Gjeçovit. Ai e kuptoi se ajo që po jetonte në gojën e popullit mund të humbiste. Prandaj e mblodhi. E shkroi. E ruajti. Dhe ia dorëzoi historisë.

Kanuni mund të studiohet sot për mënyrën se si rregullonte familjen, martesën, pronën, kufijtë, mikpritjen, marrëdhëniet ndërmjet bashkësive, kuvendin, nderin, besën dhe konfliktin. Por ai duhet lexuar si dokument historik e kulturor, jo si ligj i kohës sonë.[5] Ky dallim është thelbësor. Sepse dashuria për traditën nuk duhet të na bëjë të verbohemi përballë historisë.

Në historinë e Dukagjinit ka njerëz që nuk mund të kalohen me një fjali. Njëri prej tyre është At Shtjefën Gjeçovi. Në Theth ai nuk ishte vetëm meshtar. Ishte mësues, mbledhës i kulturës popullore

dhe studiues.

Në vitin 1917 ai hapi në Theth një shkollë ku fëmijët mësonin shkrim e këndim në gjuhën shqipe. Burime të traditës lokale e vendosin hapjen më 2 shkurt 1917 dhe përmendin rreth 25 nxënës, megjithëse numri duhet trajtuar me kujdes si një e dhënë e traditës dhe jo si statistikë e padiskutueshme arkivore.[6] Më pas Gjeçovi vazhdoi veprimtarinë arsimore edhe në Prekal. Në të njëjtin vit, në Plan u hap edhe shkolla e lidhur me veprimtarinë e At Justin Rrotës; dokumentimi lokal përmend 24 nxënës të regjistruar në fillim të dhjetorit 1917.[7]

Këto nuk janë vetëm data. Janë dëshmi. Dëshmi se në një trevë ku rrugët ishin të vështira, ku dimri mbyllte kalimet dhe ku shteti kishte shumë pak prani, dëshira për dije ishte e gjallë. Fëmija dukagjinas nuk kërkonte vetëm bukë. Kërkonte edhe shkronjën. Dhe kjo është një nga pamjet më të bukura të historisë së kësaj treve.

Gjeçovi nuk mblodhi vetëm rregulla. Ai dëgjoi popullin. Mblodhi fjalë të urta, gojëdhëna, zakone, këngë dhe dëshmi të jetës së përditshme. Në këtë kuptim, ai ishte një nga njerëzit që kuptuan se kultura nuk jeton vetëm në libra.

Ajo jeton në gojën e plakut. Në këngën e burrit. Në vajin e gruas. Në përrallën që i tregohet fëmijës. Në fjalën e dhënë. Në mënyrën se si pritet miku. Në mënyrën se si përcillet i vdekuri. Në mënyrën se si një nënë i mëson fëmijës emrat e të parëve. Kjo është arsyeja pse Dukagjini ka një pasuri që nuk matet me metra katrorë. Ai ka një arkiv të gjallë.

Kur flasim për malësorin, shpesh imagjinojmë burrin. Kjo është vetëm gjysma e Dukagjinit. Gjysma tjetër është gruaja. Ajo që qëndroi në shtëpi kur burri largohej. Ajo që rriti fëmijët. Ajo që punoi tokën. Ajo që mbajti shtëpinë gjallë. Ajo që priti mikun. Ajo që përballoi dimrat. Ajo që ruajti këngët. Ajo që ua mësoi fëmijëve historinë e familjes. Në shumë raste, ajo nuk shkroi në libra, por e ruajti kulturën duke e jetuar.

Historia e Dukagjinit duhet të rishkruhet edhe përmes kësaj figure. Jo vetëm gruaja si simbol i sakrificës, por gruaja si bartëse e kulturës. Sepse shumë nga ato që ne sot i quajmë "traditë dukagjinase" kanë kaluar nga brezi në brez përmes grave.

Një vend nuk bëhet i madh vetëm nga malet. Bëhet nga njerëzit. Dhe pwr Dukagjini ka njerëz që e kanë shkruajtur dhe kapërcyer kufirin e krahinës.

At Shtjefën Gjeçovi është një nga shembujt më të mëdhenj. At Justin Rrota është një tjetër. Në Plan ai punoi si famullitar e mësues dhe u mor drejtpërdrejt me gjuhën dhe kulturën e kësaj treve. Kontakti me të folmen e Dukagjinit u bë edhe pjesë e interesave të tij gjuhësore.[8] At Daniel Gjeçaj, përfaqëson një tjetër faqe të historisë së kësaj treve. Jeta e tij lidhet me kulturën, klerin, mërgimin dhe përpjekjet për ruajtjen e kujtesës shqiptare jashtë vendit. Burime lokale e paraqesin si një nga figurat e rëndësishme të kujtesës kulturore të Thethit dhe Dukagjinit.[9] Edhe Pjetër Gjoka, një nga emrat e rëndësishëm të teatrit dhe kinematografisë shqiptare, kishte rrënjë familjare në Dushman të Dukagjinit.[10]

Këta njerëz tregojnë diçka të rëndësishme: Dukagjini nuk prodhoi vetëm malësorë. Prodhoi kujtesë, dije, art dhe kulturë. Ka vende ku historia shkruhet në arkiva. Ka vende ku shkruhet në gur. Dhe ka vende ku historia këndohet. Dukagjini është një prej tyre.

Kënga popullore, lahuta, fyelli, gojëdhënat, legjendat dhe rrëfimet kanë qenë një lloj biblioteke e gjallë. Para se historia të shkruhej në libra, ajo jetonte në kujtesën e njerëzve.

Një plak i tregonte një djaloshi se nga vinte fisi. Një burrë i tregonte një tjetri për një luftë të vjetër. Një grua i mësonte vajzës një këngë. Një familje ruante një histori që kishte kaluar nëpër pesë a gjashtë breza. Kështu krijohej kujtesa kolektive. Dhe ndoshta kjo është arsyeja pse në Dukagjin edhe sot emri i një vendi mund të hapë një histori të tërë. Një shkëmb. Një krua. Një urë. Një kishë. Një kullë. Një varr. Gjithçka mund të jetë një libër.

Këtu ajo qw shkruajm nuk mund të mbetet vetëm te bukuria. Sepse pas kartolinës turistike fshihet një dramë. Zbrazja. Emigrimi. Braktisja e fshatrave. Ikja e të rinjve. Mungesa e shërbimeve. Vështirësitë e transportit. Një pjesë e Dukagjinit është larguar nga vetë Dukagjini.

Burime të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" japin për fundin e vitit 1990 një shifër prej rreth 17 mijë banorësh për hapësirën që ajo e përkufizon si Dukagjin, ndërsa theksojnë se pas viteve '90 një pjesë e madhe e popullsisë u zhvendos drejt Shkodrës, qyteteve të tjera dhe emigracionit. Këto të dhëna janë historike dhe duhen dalluar nga statistikat aktuale administrative.[11]

Por edhe pa statistika, mjafton të shohësh disa fshatra. Shtëpi të mbyllura. Oborre të mbuluara nga bari. Kulla ku dikur kishte zëra fëmijësh. Shkolla që humbën nxënësit. Dhe male që janë ende aty, por njerëzit janë më pak. Kjo është një nga tragjeditë më të mëdha të Shqipërisë së sotme.

Ne po zbulojmë bukuritë e maleve në të njëjtën kohë kur po humbasim njerëzit që i kanë ruajtur ato.

Sot Thethi dhe hapësirat e tjera të Alpeve janë bërë ndër destinacionet më të kërkuara të turizmit malor në Shqipëri. Vetë autoritetet turistike e paraqesin Thethin si një qendër të rëndësishme alpine, me bujtina dhe arkitekturë tradicionale.[12]

Kjo është një mundësi e jashtëzakonshme. Turizmi mund të sjellë të ardhura. Mund të hapë vende pune. Mund t'i rikthejë vlerën pronës. Mund t'i japë një arsye të riut për të qëndruar. Mund të rikthejë në fshat njerëz që dikur u larguan. Por turizmi mund të bëhet edhe armik. Nëse ndërtohet pa kriter. Nëse natyra shndërrohet në mall. Nëse çdo livadh bëhet parking. Nëse çdo kullë shndërrohet në dekor. Nëse çdo shtëpi tradicionale prishet për t'u zëvendësuar me një godinë pa lidhje me vendin. Atëherë kemi fituar turistin dhe kemi humbur Dukagjinin. Prandaj zhvillimi duhet të ketë një parim: Turizmi duhet ta mbajë gjallë vendin, jo ta zëvendësojë atë.

Dukagjini nuk duhet ruajtur si një muze i madh i hapur. Një muze e ruan të kaluarën, por e ngrin në kohë. Dukagjini duhet të jetë i gjallë. Duhet të ketë shkolla. Duhet të ketë fëmijë. Duhet të ketë familje. Duhet të ketë bujqësi e blegtori. Duhet të ketë internet. Duhet të ketë rrugë. Duhet të ketë mjek. Duhet të ketë transport. Duhet të ketë mundësi pune. Dhe duhet të ketë njerëz që zgjedhin të jetojnë atje. Sepse nuk mund të mbrohet kultura e një vendi nëse largohen njerëzit që e mbajnë atë kulturë gjallë.

Nuk mjafton të restaurojmë një kullë. Duhet të ruajmë familjen që do të jetojë në të. Nuk mjafton të fotografojmë një veshje. Duhet të ruajmë dorën që di ta punojë. Nuk mjafton të regjistrojmë një këngë. Duhet të ketë dikush që ta këndojë. Nuk mjafton të flasim për mikpritjen. Duhet të ketë ende një derë që hapet. Nëse një ditë do të hartohej një "Kartë e Kujtesës së Dukagjinit", ajo nuk do të duhej të përmbante vetëm monumentet. Do të duhej të përfshinte: kullat dhe arkitekturën tradicionale; gojëdhënat dhe këngët; të folmen e Dukagjinit; emrat e vendeve dhe historitë që lidhen me ta; recetat tradicionale; punimet artizanale; veshjet; fotografitë e familjeve; dokumentet e vjetra; varrezat dhe kishat; kujtesën e shkollave dhe të mësuesve; historitë e emigrimit; dhe, mbi të gjitha, kujtesën e njerëzve të zakonshëm.

Sepse historia e një treve nuk është vetëm historia e princërve. Është historia e atij që mbolli një arë. E asaj që rriti pesë fëmijë. E mësuesit që ecte në dëborë. E bariut që flinte larg shtëpisë. E gruas që mbajti shtëpinë gjallë. E priftit që hapi një shkollë. E djalit që iku në Amerikë dhe u kthye pas tridhjetë vjetësh. E plakut që ende di një këngë që askush tjetër nuk e di. Këta janë arkivistët e vërtetë të Dukagjinit.

Më pëlqen të mendoj se Dukagjini nuk është një vend i së kaluarës. Është një vend që ende po shkruan historinë e vet. Mund të ketë humbur shumë njerëz. Mund të ketë humbur shumë familje. Mund të ketë humbur shumë shtëpi. Por nuk ka humbur gjithçka. Sepse ende janë malet. Ende janë lumenjtë. Ende janë kishat. Ende janë kullat. Ende janë këngët. Ende janë njerëzit që kthehen. Ende janë ata që duan ta ruajnë. Dhe mbi të gjitha, ende ekziston një kujtesë.

Kjo është arsyeja pse Dukagjini nuk duhet parë vetëm me syrin e turistit. Duhet parë me syrin e shqiptarit. Turisti pyet: "Sa e bukur është kjo?"

Shqiptari duhet të pyesë: "Çfarë kemi bërë që kjo bukuri të mbijetojë?"

Dhe pyetja e dytë është shumë më e rëndësishme.

Ndoshta Dukagjini nuk ka nevojë që ne ta madhërojmë. Ai është madhështor edhe pa fjalët tona. Ka nevojë vetëm që ne ta kuptojmë. Të kuptojmë se pas çdo mali ka një histori. Pas çdo kulle ka një familje. Pas çdo kënge ka një kujtim. Pas çdo shtegu ka hapa njerëzish. Pas çdo varri ka një emër. Dhe pas çdo emri ka një pjesë të Shqipërisë. Prandaj, kur një ditë të ngjitesh drejt Thethit, të kalosh Shalën, të shohësh Shoshin, të zbresësh drejt Pultit apo të ndalesh në një kullë të vjetër, mos shiko vetëm peizazhin. Dëgjo.Sepse atje, ndërmjet shkëmbinjve, ujit, erës dhe heshtjes, mund të dëgjosh ende zërin e atyre që nuk kanë shkruar libra, por kanë ruajtur një popull. Dhe ndoshta kjo është e vërteta më e madhe e Dukagjinit: Ai nuk është thjesht një vend ku shqiptarët kanë jetuar. Është një vend ku një pjesë e shqiptarisë ka mësuar të mbijetojë. E sot, sfida nuk është më të mbijetojë përballë pushtuesit. Sfida është të mos humbasë përballë harresës. Sepse malet mund të qëndrojnë edhe një mijë vjet. Por një vend mund të vdesë nëse nuk ka më njerëz që ta quajnë atë shtëpi.

Dukagjini ka nevojë pikërisht për këtë: të mbetet shtëpi.

Literatura e pwrdorur:

1. Për shtrirjen historike të zotërimeve të Dukagjinëve, shih studimet mbi familjen fisnike Dukagjini dhe hapësirat e saj në Shqipërinë e Veriut, përfshirë Mirditën, Zadrimën, Pultin dhe drejt Kosovës perëndimore.
2. Lekë Dukagjini ishte princ shqiptar i shekullit XV dhe bashkëkohës i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Figura e tij lidhet ngushtë me historinë e principatës së Dukagjinëve dhe me rezistencën shqiptare ndaj pushtimit osman.
3. Agjencia Kombëtare e Turizmit e përshkruan Thethin si pjesë të Njësisë Administrative Shalë, Bashkia Shkodër, dhe veçon Ujëvarën e Grunasit, Kanionin e Grunasit, burimet e Okolit dhe malin e Harapit si pika të rëndësishme natyrore e turistike.
4. Studimi i botuar në *Acta Histriae* e trajton Kanunin e mbledhur nga Shtjefën Gjeçovi si pjesë të së drejtës zakonore shqiptare dhe thekson karakterin oral të kësaj tradite përpara mbledhjes dhe sistemimit të saj nga Gjeçovi.
5. Për përmbajtjen e Kanunit dhe ndarjen e tij në fusha që lidhen me familjen, martesën, pronën, punën, nderin, dëmet dhe pleqërinë, shih tekstin e botuar të *Kanunit të Lekë Dukagjinit*.
6. Burimet e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dokumentojnë hapjen e shkollës shqipe në Theth nga At Shtjefën Gjeçovi në vitin 1917 dhe japin si traditë shifrën rreth 25 nxënës; për këtë arsye shifra duhet përdorur me rezervë dhe jo si statistikë arkivore përfundimtare.
7. Për shkollën e Planit, burimet e botuara nga Shoqata "Dukagjini" sjellin të dhënën se At Justin Rrota hapi shkollën shqipe në vitin 1917 dhe se në fillim u regjistruan 24 nxënës.
8. Për veprimtarinë e Justin Rrotës në Plan dhe lidhjen e tij me studimin e gjuhës e kulturës së Dukagjinit, shih materialet mbi veprimtarinë e tij si famullitar, mësues dhe studiues.
9. Për At Daniel Gjeçajn, figurë e lidhur me Thethin dhe jetën kulturore të Dukagjinit, shih materialet biografike dhe përkujtimore të botuara mbi veprimtarinë e tij fetare, kulturore dhe intelektuale.
10. Për rrënjët familjare të aktorit Pjetër Gjoka në Dushman të Dukagjinit, shih materialin biografik të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini".
11. Të dhënat për rreth 17 mijë banorë në fund të vitit 1990 dhe shpërnguljet pas viteve '90 paraqiten në materiale të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"; ato duhen konsideruar të dhëna historike të burimit dhe jo zëvendësim i statistikave zyrtare të sotme.
12. Për zhvillimin e Thethit si destinacion turistik dhe ruajtjen e arkitekturës tradicionale, shih Agjencinë Kombëtare të Turizmit.

BIBLIOGRAFI E PËRZGJEDHUR

1. Gjeçovi, Shtjefën. *Kanuni i Lekë Dukagjinit* (botimet e traditës së mbledhur dhe sistemuar nga autori).
2. Malaj, Edmond. Studime mbi Dukagjinët gjatë Mesjetës dhe shtrirjen gjeografike të trojeve të tyre.
3. *Acta Histriae*. Studime mbi Kanunin, të drejtën zakonore shqiptare dhe veprimtarinë e Shtjefën Gjeçovit.
4. Agjencia Kombëtare e Turizmit. Materiale mbi Thethin dhe Alpet Shqiptare.
5. Shoqata Atdhetare "Dukagjini". Materiale dokumentare mbi historinë, arsimin, kulturën dhe personalitetet e trevës.
6. Materiale historike dhe kulturore mbi At Shtjefën Gjeçovin, At Justin Rrotën dhe At Daniel Gjeçajn.

Djali me dy thasë...

Shën Pjetri, ka një shërbesë të bukur në Parajsë. Ai qëndron në derë të Parajsës dhe pret të gjithë ata që vijnë, iu hap derën, bisedon pak me ta, dhe pasi vëren si është jeta e tyre, thotë fjalën e fundit: Në Parajsë ose në Ferr!

Kur Pjetri të flasë, askush nuk guxon ta diskutojë më, pavarësisht disave që mbesin të pakënaqur kur dëgjojnë: Ferr!

Duke dashur t'i ndihmojë njerëzit, Shën Pjetri vendos t'i përkrahë edhe gjatë shtegtimit tokësor. Kështu, një ditë i pajisi të gjithë me dy thasë: njërin për të futur brenda gjërat e mira që hasnin rrugës, tjetrin për të futur gjërat e këqija.

Një ditë, në derën e Parajsës, u paraqit një turmë e madhe popolli, një shumicë që vinte nga çdo skaj i tokës: njerëz të çdo fisi e të çdo kombësie. Ishte një turmë me të vërtetë e madhe dhe me t'i parë kështu, Pjetri mendoi se do të kishte një punë mjaft të



lodhshme. Të gjithë ishin munduar tmerrësisht me nga dy thasë plot e përplot me pesha shumë të rënda, ishin të lodhur e të rraskapitur. Disave po iu zihej fryma. Të tjerë nga fundi po tërhiqnin zvarrë thasët e vet dhe shtynin njëri-tjetrin në radhë për të pritur çertifikatën e fundit nga Shën Pjetri.

Në mesin e asaj turme, ishte një fëmijë ndoshta 10-vjeçar, i buzëqeshur që ecte drejt derës së Parajsës i vendosur dhe plot siguri.

- Po, ti, çfarë ke për të thënë? - e pyet Shën Pjetri në sy të të gjithëve.

- Edhe mua, si të gjithëve, m'u dhanë dy thasë që në fillim të jetës sime - u përgjigj plot dëlirësi vogëlushi. - Duke e ditur se rruga ishte e gjatë, me pengesa, vështirësi, fjalë, thashetheme e të tjera si këto dhe duke marrë parasysh se isha një krijesë e vogël dhe e brishtë, thesit ku do të fusja gjërat e këqija ia hoqa fundin që në fillim, që asgjë të mos më mbeste në të, sepse e dija se nuk do të mund t'i mbartja. Papritmas, erdhi dita të paraqitem këtu, dhe ja kam vetëm këtë thes plot me gjërat e bukura që kam bërë dhe përjetuar, gjërat me vlerë që i kam mësuar, por këto janë krejt të lehta, nuk më rëndojnë, madje ma kanë lehtësuar gjithë shtegtimin. Me mua kam edhe thesin tjetër, edhe ky tashmë i lehtë, sepse unë ia hoqa fundin që në fillim dhe gjatë rrugës, çdo fjalë të keqe, çdo mësim të keq, çdo përvojë negative, çdo kujtim të hidhur, çdo plagë që më shkaktohej e hidhja aty brenda dhe binte menjëherë rrugës dhe mbetej pas shpinës sime dhe thesi qëndronte vazhdimisht bosh e unë udhëtova i lirë si një zog deri këtu".

- Ti je i gatshëm për Parajsën, - i tha Pjetri djaloshit, - por duhet të kthehesh edhe një herë në tokë për shumë vite me misionin që t'u mësosh njerëzve ta hapin fundin e thesit të gjërave të këqija siç ke bërë ti.

***

Ndalu pak edhe ti, që po lexon këtë histori, dhe verifiko si i ke dy thasët e tu! Nuk është aspak vonë t'ia hapësh tani fundin thesit të gjërave të këqija e të ecësh drejt përpara i lirë nga peshat e kota!

Nikolin Sh. Lëmezhi
Shkodër, më 24. 04. 2020

Aforizma

(përgatiti: Nikolin Sh. Lëmezhi)

Çdo ditë sjell me vete një mundësi…
një shpresë të re…
ji i vëmendshëm… mos i lër të ikin…!

Zoti e shndërron dhimbjen në jetë të re:
Besoje!

Për sa kohë je skllav i një vesi,
nuk do të arrish as madhështi, as liri.

Mos mendo kurrë se vlera jote
varet nga opinionet e të tjerëve!
Vlera jote varet nga vlerat që jeton.

Trajtoje trupin me rreptësi,
në mënyrë që mendja
të dijë t'i nënshtrojë instinktet!

Ajo që i dhuron atij që ka nevojë, nuk shkon kot, por shndërrohet në pasuri të Përjetshme!

Njerëzit e suksesshëm nuk janë ata dembelë… që i shtyjnë gjërat për nesër…
por ata që angazhohen.

Mos bëj një mijë gjëra…
bëj vetëm atë që ka rëndësi!

Të mendosh mirë!
Është hapi i parë drejt paqes së zemrës.

Përpara se të mësosh, dëgjo…
Përpara se të gjykosh, duhet të njohësh.

Në jetë njeriu nuk realizohet
duke ndjekur kënaqësinë, por në përmbushjen e detyrës.

Liria nuk është të bësh
"atë që dëshiron",
por të bësh atë që duhet.

Mendo më pak për atë që të rëndon
dhe pak më shumë për gëzimet që ke përjetuar!
Do të ndihesh më mirë.

Përqendrohu tek ajo që ka vërtet rëndësi!
Mos e shpërdoro kohën dhe energjitë
për atë që është e padobishme!

Në jetë, hijet rriten
kur zemra dorëzohet!

Ki sy të mëshirshëm dhe duar bujare!
Mos u kënaq me atë që je dhe me atë që di.

E kaluara jote nuk e kufizon dhe nuk e kushtëzon të ardhmen tënde!

Përpara se të shkruash, mendo,
përpara se të dorëzohesh, provo!
Ki shpresë në beteja!

Është mirë të ndihesh i shpërblyer nga suksesi…
por është shumë e rëndësishme
të mësosh nga dështimet!

Humori i mirë prodhon shumë energji pozitive… Nxirre nga brenda vetes dhe përdore në marrëdhëniet me të tjerët!
Nëse do të kuptosh…
Nëse do të gëzosh: Dashuro!

Dashuria është një dritë brenda teje.

Mëso të qesh me veten
para se ta bëjnë të tjerët!

Mos prit një buzëqeshje
për të qenë i sjellshëm!

Mos prit të të duan të tjerët
që të fillosh të duash!

Mos prit të jesh i vetmuar
për të kuptuar vlerën e një miku!

Mos prit punën më të mirë,
që të fillosh të bashkëndash me të tjerët!

Mos prit të kesh kohë
që të fillosh të shërbesh!

Mos prit dhimbjen e një të afërmi
për të kërkuar falje,
as thyerjen për t'u pajtuar me të!

Mos prit punën më të mirë,
që të fillosh të bashkëndash me të tjerët!

Mos prit të kesh kohë
që të fillosh të shërbesh!

Mos prit dhimbjen e një të afërmi
për të kërkuar falje,
as thyerjen për t'u pajtuar me të!

Mos prit të kesh kohë
që të fillosh të shërbesh!



Paulin Gjeka - një prind shembullor, një burrë me faqe të bardhë!

Paulin Gjeka ishte një prind shembullor dhe një burrë i ndershëm, që gjithë jetën e tij ia kushtoi familjes. Në një kohë kur të rrisësh e të shkollosh fëmijët me djersën e ballit, me punë të ndershme dhe me dinjitet, është gjithnjë e më e vështirë, Paulini zgjodhi rrugën më të vështirë, por më të pastër: punën dhe ndershmërinë. Prej vitesh ai punonte punëtor krahu, kudo ku gjente mundësi, vetëm që familjes së tij të mos i mungonte asgjë. Synimi i tij nuk ishte pasuria, luksi apo një jetë e shfrenuar. Ai kërkonte vetëm një jetë të thjeshtë, normale dhe me dinjitet, që fëmijët e tij të rriteshin, të shkolloheshin dhe të mos ndienin mungesat e gjërave bazë.

Papritur, Paulini u sëmur rëndë dhe qëndroi për më shumë se një muaj në spital. Kur shkova ta shihja në reanimacion, pamja e tij ishte e dhimbshme. Fizikisht ishte shumë i lodhur dhe mezi merrte frymë pa ndihmën e aparaturave. Por, edhe në atë gjendje të rëndë, Paulini përcillte forcë. Më pa drejt në sy, më zgjati njërën dorë dhe ma shtrëngoi aq sa mundi. Me dorën tjetër ma bëri me grusht, sikur donte të më thoshte: "Mos u merakosni, do t'ia dal. Jam ende i fortë!"

Folëm shumë pak, sepse nuk doja ta mundoja më tepër. Rreth krevatit ishin familjarët, të gjithë të mërzitur e të përlotur. Për ne, të afërmit, ishte e vështirë të përmbaheshim. Por ndodhte diçka e veçantë: në vend që ne t'i jepnim kurajo Paulinit, ishte pikërisht Paulini ai që na je-



pte kurajo neve.

Ai kishte besim. Besonte se do t'ia dilte. Fatkeqësisht, pas pak ditësh, Paulini nuk mundi t'i mbijetonte sëmundjes së rëndë dhe dhimbjeve.

Ai ndërroi jetë, duke lënë pas familjen, gruan e fëmijët dhe një jetë të tërë të ndërtuar me punë e sakrificë. Paulini punoi gjithë jetën me ndershmëri dhe mundi i tij nuk shkoi dëm. Ndoshta nuk i la familjes një pasuri të madhe, vila apo luks, por u la diçka shumë më të çmuar: nderin, dinjitetin, respektin dhe faqen e bardhë. U la fëmijëve një emër për të cilin mund të jenë krenarë dhe një shembull, që do t'i shoqërojë gjatë gjithë jetës.

Një nga pamjet më prekëse ishte ajo e djalit të tij, Klevisit, vetëm 15 vjeç. Në atë moshë kur një fëmijë duhet të ketë pranë babanë e tij, Klevisi qëndronte mes burrave të Shllakut, duke u përpjekur të përmbante lotët. Me paketën e cigareve në dorë, sipas traditës së burrërisë e të mortit, u jepte cigare burrave dhe me fjalët e tradites u thoshte: "Burra, paçi faqen e bardhë dhe ua kthefshim në gëzime në familjet tuaja!"

Ishte vetëm 15 vjeç, por qëndronte si burrë. Një djalë i Shllakut me zemër guri përpara njerëzve, por me shpirt të thyer e të copëtuar nga brenda. Përpiqej të mos i tregonte lotët, sepse kështu e kërkon tradita, por dhimbja e humbjes së babait ishte aty, në sytë e tij.

Klevisi dhe tri motrat e tij humbën babanë, por fituan një trashëgimi shumë të madhe: shembullin e një prindi që jetoi me punë, ndershmëri dhe dinjitet.

Paulin Gjeka, pushoftë në paqe!

Kujtimi yt qoftë i përjetshëm për familjen, të afërmit, miqtë dhe çdo njeri që pati fatin të të njohë!

Klevisi, qofsh jetëgjatë dhe qofsh gjithmonë krenar për babanë tënd, për njeriun që të rriti ty dhe tri motrat e tua me djersën e ballit, me ndershmëri dhe me faqe të bardhë!

I paharruar qoftë kujtimi i Paulin Gjekes!

Lamtumire Paulin Gjeka!

Nga **Mark Gjeka**

Halil Bashota na gëzoi me këtë roman!

Këto ditë të nxehta e përvëluese të Gushtit 2026, shkrimtari Halil Bashota na gëzoi me romanin e tij ''Sërish në Alpbah'' - botim i shtypshkronjës "LENA Grafik" të Prishtinës, me redaktor Xhevder Rusinovci, lektor Lenora Kasumi, dizenje Andri Zabeli.

Kjo është vepra e tij e tretë pas ''Heroi tragjik në tragjedinë e Shekspirit" (kritika letrare) dhe ''Të jetosh në një kohë tjetër"- poezi.


Shkrimtari e poeti Halil Bashota ka lindur në qytetin e Klinës, me 1. 1. 1981, në një familje patriotike, bujare, atdhedashëse dhe fisnike. Shkollimin detyrueshëm dhe gjimnazin i mbaroi me rezultate të larta në vendlindje. U diplomua në Universitetin Shtetëror ''Hasan Prishtina" në Prishtinë, në degën e gjuhëve të huaja (anglisht) me rezultate të larta.

Menjëherë punësohet në Ministrin e Arsimit në Prishtinë, në sektorin e arsimit të lartë (inspektor) për periudhën 2005 deri 2010 dhe pastaj merr detyrën e Profesorit në Universitetin UBT (Unversiteti i Biznesit dhe i Teknologjisë) në Prishtinë, duke ligjëruar lëndën ''Letërsinë Anglo-Amerikane", deri sot.

Gjithashtu Halili pas fakultetit, po në Prishtinë, mbrojti masterin për Letërsinë Anglo-Amerikane dhe më vonë në Universitetin Karl-Framzens të Granzit, mbrojti Doktoratën ''Letërsia Anglo-Amerikane"

Le të ndalemi te autori:

Shkrimtari dashamirës Halil Bashota



ka botuar këtë roman autentik, ku vetë autori e ka përjetua ngjarjen reale, duke qenë vetë prezent.

Ky libër mundet të krahasohet me "Hasta la vista", të shkrimtarit vlonjat, Petro Marko. Romani ka vlera artistike, ku autori me mjeshtëri ka përdorur metaforën, krahasimin dhe imazhin e figurave. Kjo e pasqyruar në simbolikën e Shqiptarëve për traditat.

Frymëzimi i shkrimtarit vjen nga një veprimtari ndërkombëtar, të organizuar nga Forumi Evropian me pjesëmarrjen e shumë shteteve me delegacionet e tyre. Në këtë veprimtari paraqitet edhe delegacioni i Kosovës, i kryesuar nga ish Kryeministri i Kosovës, Agim Çeku dhe delegacioni i Shqipërisë, i kryesuar nga ish Kryetarja e Kuvendit Jozefina Topalli. Romani ka në qendër të tij dy personazhe kryesorë: Stilin dhe Matildën, dy të rijnë kosovarë e shqiptarë që bien në dashuri gjatë kësaj veprimtarie ndërkombëtare. Kosovarja dhe ky Tiranasi shprehin dashurinë e sinqertë njëri me tjetrin, ku vetë pjesëmarrësit e shprehën shumë dashamirës për këta të dy të rinjtë.

Në fund romani përfundon, siç e ka vetë imazhin e librit "Sërish në Alpbah". Ndoshta shkrimtari Halil Bashota e ka në plan një roman të dytë në vijimësi për t'i bashkuar përfundimisht këtë çift të ri.

Ibrahim Hadarmataj, *gusht 2026*


Promovohet libri që dokumenton gati një shekull arsim në Shllak, Temal- Dushman.

Është promovuar libri "Arsim – Kultura Shllak, Temal, Dushman", me autor Ndoc Prendushin, nga Vukajt e Shllakut, i cili për 44 vjet i shërbeu arsimit në këtë krahinë.

Ky botim sjell në vëmendje historinë e arsimit dhe të zhvillimit kulturor në krahinen e Shllakut, duke dokumentuar punën e brezave të mësuesve dhe kontributin e tyre në edukimin e shumë brezave nxënësish.

Sipas të dhënave të paraqitura, në krahinen e Shllakut kanë funksionuar 17 shkolla fillore, 7 shkolla nëntëvjeçare dhe një shkollë e mesme. Në këtë krahinë kanë punuar mbi 300 mësues, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në përhapjen e dijes dhe në formimin arsimor të banorëve.

Përveç institucioneve arsimore, jeta kulturore e zonës mbështetej edhe nga institucione të tjera, ndër to edhe shtëpia e kulturës, e cila shërbente si hapësirë për veprimtari kulturore dhe artistike si dhe 3 vatra kulture ne Vukaj ne Bene dhe Telume



Libri i Ndoc Prendushit përbën një përpjekje për të ruajtur kujtesën historike të arsimit në Shllak, Temal-Dushman dhe për të vlerësuar punën e mësuesve që ndër vite kontribuan në zhvillimin e kësaj treve.

Përmes këtij botimi, historia e shkollave, e mësuesve dhe e jetës kulturore të krahinës u përcillet brezave të rinj si pjesë e trashëgimisë arsimore dhe kulturore.

Nga Mark Gjeka

KATËR DRITA



Ese nga **GJON MARKU**

Nata zbriti mbi male ashtu siç zbret gjithmonë, ngadalë, pa zhurmë, si dikush që hyn në shtëpi me kujdes që të mos zgjojë njeri. Dola në ballkon, dhe qielli m'u shfaq me mijëra pika drite, si të donin të më thoshin: nuk je vetëm, shiko sa shumë jemi këtu sipër.

Kërkova ndër to. Gjeta atë më të ndriçuarën, atë që dukej sikur pulson më ngrohtë se të tjerat, dhe i vura emrin e nënës. "Ja ku je," mendova. "Ende po më shikon, ende po m'i ngroh duart nga larg."

Pak më poshtë gjeta një tjetër, më të vogël, më të druajtur, sikur ende s'ishte mësuar me errësirën. Vëllai im, thashë me zë të ulët - ai që s'pati kohë të rritej me mua, por që tani është rritur në një qiell tjetër. Ai që nuk priti që unë të lindja.

Kërkova edhe një herë. Gjeta atë që dridhej pak, si dikush që lufton edhe atje lart. Baba. Ai që u lodh shumë këtu poshtë, dhe tani ndoshta më në fund pushon.

Dhe një, i ri, ende pothuajse i vitit të parë atje, ende me dritën e freskët të dikujt që sapo ka mësuar të shkëlqejë. Motra ime. Liza thashë .

Katër drita. Një familje e shpërndarë nëpër qiell, ndërsa unë qëndroja vetëm mes mureve të gurta të një shtëpie ku dikur kishte zëra, dhe tani ka vetëm jehonë.

Kullat nëpër male nuk folën. Nuk kishin nevojë. Ato kishin parë shumë netë si kjo - burra e gra që kërkonin dritë mes yjeve, sepse toka nuk ua kthente më njerëzit e vet.

Legjendat e maleve nuk janë gjë tjetër veçse kjo: mall i mbledhur, brez pas brezi, që s'ka gjetur ku të shkojë, prandaj ka vajtur lart, tek yjet, sepse yjet, ndryshe nga njerëzit, nuk largohen kurrë njëherësh të gjithë.

Qëndrova ashtu, kokën lart. Dhe kur më në fund u ktheva brenda, nuk isha më krejtësisht vetëm - kisha katër emra në kujtesë, dhe një natë të treguar, e cila tani i përkiste dikujt tjetër përveç heshtjes.

Ty, vëlla, s'të mjaftoi koha as të mësoje ç'do të thoshte të jetoje. U ktheve në dritë para se toka të të njihte mirë. Kushedi sa i ka therur në zemër nënës dhe babait tonë kur ndërrove jetë, ti që ishe drita e syve të tyre. E megjithatë, unë të kam menduar gjithë jetën si vëllain e madh që s'të pata - se ke jetuar në një kohë tjetër, do të më kishe mësuar të hipja në pemë, do të më kishe mbrojtur nga frikëra që as nuk shiheshin. Nuk pata rastin të zihem me ty, të të zemërohem e pastaj të të fal. Nuk pata rastin as të të njihja. Por sonte të them: më ke munguar në një mënyrë që s'ka emër - mungesa e dikujt që s'e pata kurrë, por që e ndjej gjithsesi si vrimë në kraharor. Prit atje lart, dhe kur të vij, më mëso gjithçka që s'pata kohë ta mësoj në këtë botë.

Dhjetë vjeç isha kur më le, baba. Aq i vogël sa as nuk e kuptoja mirë ç'do të thoshte "përgjithmonë". Por akoma kujtoj zogjtë, kuajt, dhelprat, lepujt që gdhendje me durim, natë pas nate, vetëm që të m'i plotësoje dëshirat, që të gëzohesha. Kam pyetur veten shpesh si do të kishte qenë të rritesha me ty pranë - të më mësoje të mbaja fjalën, të rrija në odë me burrat, dikush të më priste te dera kur vononte errësira, të më shihje si burrërohesha e të më udhëhiqje në jetë. U desh të rritesha më shpejt se ç'duhej, sepse mungesa jote la një boshllëk që dikush duhej ta mbushte, edhe pse s'kishte kush. E di që lufta jote ishte e rëndë, dhe ndoshta pushimi që more ishte i merituar, edhe pse luftove me vdekjen. Por dua të dish: çfarëdo që arrita, e arrita duke mbajtur në mendje edhe zërin tënd, edhe pse tani më kujtohet i mjegullt.

Faleminderit që ishe babai im, sado pak kohë qëndrove pranë - ti ishe dhe mbetesh nderi dhe krenaria ime e përjetshme.

Ty, nënë, të kam parë të lodhesh në heshtje shumë net, ndërsa përpiqeshe të mbushje dy vende me një trup të vetëm - babain dhe nënën njëkohësisht. Nuk ta thashë sa herë duhej sa shumë e vlerësoja atë çfarë bëje. Ndoshta mendova se do të kem gjithmonë kohë ta them nesër. Sonte po ta them: ti më dhe gjithçka që s'e kishe vetë. Duart e tua u plakën duke punuar për të miat. Dhe tani, kur kërkoj yllin më të ndritshëm, të gjej ty - sepse edhe atje lart nuk je ndalur së shkëlqyeri për mua. Ti je dhe mbetesh pasqyra e pjesës më të mirë të vetes sime. Dua të dish: çdo herë që shkoj mirë në diçka, të falënderoj ty në heshtje, sepse pjesë e asaj force ma dhe ti.

Ti, motër, ishe krahu që s'e dija se e kisha, derisa u nisa vetëm drejt qytetit. Më prisje me ushqim gati, më pyesje si shkoi provimi para se të hyja mirë nga dera, më qortoje kur flija pak dhe më ngrije moralin kur mendoja se s'do ia dilja. Vetëm një vit ka që ike, dhe ende kthej kokën ta të them diçka, e pastaj kujtohem se s'je më.

Kjo dhembje është ende e freskët, si plagë që s'është mbyllur mirë.

As vetë s'e di si më erdhi ky moment - një çast, ndër qiej, m'u duk sikur ju pashë si katër drita. Katër drita, katër fjalë që tani janë thënë - jo nesër, jo "kur të kem kohë", por sonte, ashtu siç duhej.

Jetë Shkodrane!

Roman nga Cuk Simoni -

Kohët e fundit, doli në qarkullim romani i autorit Cuk Simoni "Jetë Shkodrane"nga Berk, 2022, 227 fq. 20cm- (Radhonjtë e shêjzave).

Për nji shkodran që ndalet në Librarinë "Ora e Shkodrës", në qendër të qytetit, duke hedhur sytë nga stendat e librave dhe vënë ore nji libër, kopertina e të cilit ka nji foto me gra shirokase, me kostume popullore qytetase, në festën e Shna Rrokut me 16 Gusht 1913, grishet të shfletoj pak faqet e para të librit, nji jetëshkrim për autorin Cuk Simoni, lëvrues i përvujtun i Letrave Shqipe e, siç asht rëndom zakoni me i hedh nji sy edhe në kopertinën e mbrapme, nuk pyet për çmimin (1000lekë), e mbështjellë e del nga libraria.

Ftesë!

Për miq e shokë të mi moshatar dhe ato që ende e duan Shkodrën edhe pse janë larg saj, për ato që në memorien e tyre e përfytyrojnë qytetit nga kallximet e gjyshërve, të prindërve dhe nga librat e dikurshme, për ato që besojnë fjalëve të mia, ju them: blijeni librin, lexojeni dhe mbani shënime, asht nji mrekulli e jetës shkodrane që nga shekulli i 19-të, në periudhën e Lidhjes së Prizrenit, e deri kur, ajo u modernizua sadopak në vitet '30 të shekullit të kaluar, kur lindi nji letërsi e mrekullueshme me autor të spikatun, kohë që njihet si "Letërsia e viteve '30-të" e intelektualëve të kohës.

Ju, mësoni deri diku, edhe si ishte qyteti asokohe, qendrat e tij, Pazarin e vjetër, rrugët me kalldrëme me vijat e ujit që mblidhnin ujerat e shirave dhe vërshimet e lumi Kir, urat lidhëse, lagjet e vjetra, Ajasmën, Parrucën, Serreqin, Gjuhadolit, Arrës së Madhe lagje kjo mà periferike e ma popullore, dhe Bardhanjorin, zakonet në qytet, marrëdhëniet në mes njerëzve, qeveritarët e kohës, zakonet e dasmës shkodrane.

Mjaft me kaq!

Unë po cekë dy aspekte nga libri, njërin si fenomen dhe të dytin, fjalë dhe frazeologji në shkodranisht, harruar sot në përdorim.

1. Fenomenologjia në dy kohë.

Fenomenologjia sociale tregon se çfarë roli luan vetëdija njerëzore në prodhimin e veprimit shoqëror, situatave sociale dhe botëve shoqërore.

Në roman (citim):

"*Ndryshimin e jetesës ndërmjet vendeve perëndimore e Shqipnîs përshkrueshin me ngjyra të ndezta sidomos nga ata qi kishin pasë rasë me kalue përtej detit, numri i të cilëve vinte përherë tue u shtue. Por, si ndodhë gadi shpesh ndër këso prirjesh edhe kjo kalonte në tepri. Njerz të shtym prej andjes me diftue vedin të shetitun e qi kishin pa botë me sy, nuk u kufizojshin me lavdue në mënyrë të ekzagjerueme jeten qi bahej përjashta, por kishin fjalë përbuzjet për mënyrën e jetesës sonë, për të gjitha çfaqjet e ndryshme të shoqnis e familjeve tona. E gati e shumta e këtyne njerzve ishin djelm të ri e burra mendjelehtë qi pak i kishin hy mbrendë botës së jashtme. E natyrisht këta ishin ma të nxehtit*".

Sot, koha e dytë e fenomenologjisë.

E thanë mà thjesht, fenomenologjia si përvojë e jetuar e botës së një individi.

Shumë nga njerzit tonë, të emigruar në perëndim, sapo u çliruan nga vuajtjet e para të sistemimit në vendet ku jetojnë, pasi qëndruan nën ura, në rezidenca të Karitasit, pasi paguan shumë nga paga e tyre për taksa, për muta, për remitancat në vendin e tyre, ju turren Shqipërisë ku i gjetën dhe ku s'i gjetën fjalët më denigruese, thua se fajin ja pat mëmëdheu e jo mbrapambetja shekullore me atje ku jetojnë, madje, edhe do "bukuroshe me butoks" ne TV-t tona janë kthyer Shqipërisë se këtu nuk jetohet se ky vend nuk bëhët e të tjera e të tjera.

Shqipëria asht nji shoqëri në zhvillim, madje po ecën përpara për të kapur kohën e hupur, nëse, ajo (koha) qëndron në vend!

Shpesh, më vjen në mendje pasazhe nga filmi " Familja e Peshkatarit " e S. Pitarkës. Replikat në mes Jonuz Brugës (babai) dhe Selimit (i biri, fashist).....i inatosur me sjelljet e Selimit,…i kthehet :

Shiko!, - mua mos më duaj, zatën as satëme që të bani kokën, mos e duaj, (dridhet dhe e çon zanin!) .... por Shqipërinë, Shqipërinë,...ta duash!

Përgjigja ime për dy kohët e Fenomenologjisë në këtë raste.

2. Fjalë dhe frazeologji në shkodranisht, në roman, faqe pas faqe (shkodranët, veçanërisht duhet me i përdorë):

- njashtu
- kah ì herë
- degame = grindje
- me dokëdo = jo, me të gjithë
- njinjishme
- pa pare pa pullë
- dokudo = jo, gjithëkund
- sjellja e tij ishte nji për nji, nëmos edhe ma tërhjekëse se duka.
- me u lvyer
- Dizoti = në të vertetë.
- fill e për pê = hollë – hollë.
- me ra në gòdi = me ra dakort.
- ngiat (ngjat) = afër, pranë.
- treme = hajat.
- pajadà = pa ndërprerje.
- kahmot
- kotnasikot = krejt kot, pa qëllim.
- si nji ditë përditë
- Po ju marr n'gryk të gjithëve, e po iu falem me shndet me gjithë zemër.
- ...
- ...

Dikund në libër:

"*E fëmija mandej qi, si asht natyra e moshës së tyne, nuk nxejshin kurrkund vend e dojshin me prekë gjithçka, merrshin natyrisht tash e tash brimën e nanave : - po ti mos pritsht, ty të raftë pika, s'i s'zune vend kurr sonde..... e të tjera këso nâmë dashtënije. Sa qi ndonji teze , a ndonji hallë a ndonji tjetër ia pritte : - Lene moj të losin, nuk po ban kuugja, njomja e vogël, ty të marrsha të keqen, luej moj zemër se nana asht faqezezë, tash po e rrahi vetë.*

E fëmija ngiste e strukej në prehën të nanës faqezezë tue kqyrë me bisht synit e me dyshim atë qi e donte aq fort".

Oh, sa ka të tilla romani deri në fund, veç, për me u pajisë mirëfilli kështu, duhet me e lexu librin.

Tash, në fund.....nxitoni e lexoni romanin e jashtëzakonshëm "Jetë Shkodrane ", sa nuk iku vera, e leni për netët dimri, romancat rozë!

LEONARD QYTEZA,
Shkodër me 8 Gusht 2022

DUKAGJINI, THESARI I PASHFRYTËZUAR I SHQIPËRISË

Në zonën e Dukagjinit të Shqipërisë u mbajt manifestimi tradicional "Dita e Rinisë Dukagjinase".

Falë kontributit të dhënë për këtë manifestim nga nikoqiri Kolë Gjoni, burr nga zona e Shoshit, ky manifestim u mbajt në mënyrën më dinjitoze dhe perfekte, duke u bërë realitet ideja e këtyre të rinjve dukagjinas.

Këtë manifestim e ndihmuan edhe disa anëtarë të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", të cilët dhanë kontributin e tyre, në krye me Dukate Bregun, Roza Mhill Pjetrin dhe Agron Hasanin.

Nën tingujt e bukur të këngëtarëve dukagjinas të mirënjohur, Viola Shqau, Noel Pjetri dhe Gentia Gropa, u realizua në mënyrë madhështore festa dyditore "Dita e Rinisë Dukagjinase".

Manifestimi u mbajt në vendin e quajtur Nderlysaj, pikë kyçe e zonës, në restorantin "Veni i Gjyshit".

Dashuria për këto zona, Theth, Shalë dhe Shosh, i bën dukagjinasit unikë dhe të pathyeshëm në komb, fe dhe traditë.

Me bashkëfinancimin e Kolë Gjonit dhe disa dukagjinasve, të cilët nuk dëshirojnë t'u përmenden emrat, u mbajt manifestimi madhështor "Dita e Rinisë Dukagjinase".

Edhe pse për këtë manifestim do të duhej që Bashkia e Shkodrës të ndante një buxhet simbolik për këtë aktivitet kulturor, ai u realizua falë vullnetit dhe përkushtimit të organizatorëve dhe kontribuesve të zonës së Dukagjinit.

Qytetarët e kësaj zone janë duke punuar vazhdimisht që të kthehet jeta dhe tradita në këto anë të virgjëra. Është për të ardhur keq që ky vend ka mbetur në mëshirën e fatit.

Është e ditur se ky vend dikur ka qenë vatër e kulturës, kishte nënprefekturë, bashki, shkolla, spital, ushtri e, mbi të gjitha, ishte vend kanunor, ku fjala, besa e nderi ishin mbi të gjitha.

Andaj, në këtë vend duhet ta duam e ta mbrojmë, sepse është zonë e lashtë historike; për shqiptarinë është një aset kombëtar.

Të eksplorosh këto zona të Dukagjinit duhet ditë të tëra, sepse, posa fillon të hysh në fshatin Bogë, frymon ndryshe, duke thithur ajër të pastër dhe duke mos u ngopur me bukuritë e natyrës që Zoti ia ka dhuruar kësaj zone të virgjër, e cila ka një larmi të jashtëzakonshme të bimësisë të ndryshme.

Është vend ku mushkëritë të buzëqeshin dhe zemra fluturon nga pastërtia e ajrit.

Duke vazhduar nëpër rrugët gjarpërore deri në Theth, syri të kënaqet me pamje mahnitëse: kishën e vjetër, Kullën e Ngujimit dhe ujëvarat mes shkrepave të Thethit, të cilat të lënë pa frymë nga bukuria përrallore.

Duke vazhduar rrugës, pranë burimit të lumit të Shalës (burimin e ka në Theth e vazhdon derdhja në Koman), vazhdojmë eksplorimin deri te Vaskajt e Nderlysajve, pastaj nëpër ato shkrepra deri te Syri i Kaltër, që të lë pa frymë nga bukuria dhe uji i ftohtë akull, i cili del nga mesi i shkrepave dhe gurëve të bjeshkëve të larta të Dukagjinit, ku shqiponja benë fole.

Në pjesën e majtë, Thethi e Shala kufizohen me zonën e Valbonës. Pranë lumit shohim ujin e kulluar që rrjedh me melodinë gurgulluese të rrjedhës së tij.

Mbi kreshtat e thepisura, pranë kullave të vjetra të gjyshërve e stërgjyshërve tanë, të kënaqet syri duke i parë. Shumë prej tyre janë duke u restauruar nga nipërit e tyre. Të gjithë i kemi sytë tek ata dhe presim që sa më parë të rikthehet jeta e re në Dukagjin.

Ajo rrugë gjarpërore, e shtruar vetëm me zhavorr, tregon se si dora e pushtetit e ka lënë në harresë këtë zonë.

Gjatë rrugës kaluam pranë ndërtesës së oficerëve të lartë ushtarakë të sistemit komunist, e cila ishte rrënuar dhe kërkonte dorën e shtetit për restaurim.

Kaluam pranë kulteve fetare, kishave të mbijetuara, urës e cila të çon në lagjen e Gimajve, urë e cila ka një histori në vetvete, në luftërat e kohës, sepse dukagjinasit shquheshin për burrni dhe trimëri. Po ashtu, në atë rrugë, në qendër të Shalës, pamë "Prefekturën e Shalës", e cila ishte pothuajse e rrënuar, së cilës i kishin mbetur vetëm disa mure me ngjyrë të verdhë, ndërsa pjesa tjetër ishte kthyer në një gërmadhë të frikshme.

Aty pranë Prefekturës së Shalës ishin dy shtatore: njëra me emrat e Shtatë Shaljanëve, e ndërtuar në kohën e komunizmit, ndërsa tjetra, një pllakë mermeri e pikturuar me portretet e "7 Shaljanëve të Dukagjinit", që kanë dhënë jetën për lirinë e vendit dhe luftuan kundër sundimit otoman.

Vazhduam rrugën duke eksploruar, së bashku me ekipin e Këshillit Organizativ, manifestimin tashmë tradicional "Rinia e Dukagjinit", të organizuar nga anëtarët e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini".

Dukagjini i lashtë, vend i bukur, buzë lumit të Shalës deri te Porta e Shalës, është një vend ku, sipas traditës dhe historisë së kësaj treve, asnjë këmbë krajli as mbret nuk ka mundur ta shkelë e as ta sundojë.

Pastaj kaluam në urën që të çon në zonën e Shoshit. Ajo rrugë e thepisur, me shkëmbinj dhe kthesa gjarpërore, të mahnit me bukuritë e saj. Udhëtimi ynë vazhdoi deri te fshati Shënjergj dhe te kisha e vjetër e asaj zone.

Çdo cep i Dukagjinit është plot me faunë dhe bimësi të lashtë shëruese: trumzë, gështenja, çajra mali, bliri i egër etj. Shumë gurë shkëlqyes, lisa qindra vjeçarë, lumi që vazhdon përgjatë rrugës gjarpërore dhe pyjet e mbushura me shkurre e drurë të llojeve të ndryshme të lënë pa frymë nga bukuritë natyrore që ka dhuruar Zoti.

Është për t'u befasuar se kujt nuk po i konvenon që kjo zonë të mbetet pa përkrahje nga qeveria dhe të lihet pas dore.





Është për të ardhur keq për gjithë ato bukuri që do ta zhvillonin turizmin në atë zonë dhe do të ishte një hambar turizmi për gjithë Shqipërinë.

Kurse pushtetarët nuk e kthejnë kokën nga Dukagjini për t'i dhënë një jetë të re, një shtytje përpara për të mirën e asaj zone e gjithë Shqipërisë.

Siç dihet, Dukagjini ka qenë i populluar dhe i pajisur me gjithçka që i takon një qyteti të civilizuar: vatër kulturore, arsimim, infrastrukturë, shëtitore buzë lumit, zejtari, dyqane, punishte etj. Zonë kjo që ka qenë e paprekur nga sunduesit e ndryshëm, duke ruajtur ndër shekuj identitetin, kombin, fenë, traditat, besën dhe nderin e shqiptarit.

Dukagjini i Shqipërisë është aset kombëtar dhe, mbi të gjitha, ka një kulturë të rrallë njerëzore.

Do të mbesim me shpresë se një ditë do të bëhet më e lehtë që t'i eksplorojmë të gjitha ato bukuri që kanë këto zona të Dukagjinit.

Anëtarët e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" janë duke punuar që Dukagjinit t'i kthehet dinjiteti. Për këtë foli edhe nënkryetari i kësaj shoqate, Agron Hasani, në natën e manifestimit, i cili u mbajt në restorantin "Veni i Gjyshit", me pronar Kolë Gjonin, në prani të shumë dukagjinasve të ardhur nga Kosova, Peja, Tirana, Lezha, Shkodra, nga të gjitha zonat e Dukagjinit.

Ai tha se duhet të punojmë fort që Dukagjini të ketë identitetin e zonës, të riparohet infrastruktura, të ndërtohen shkollat dhe të kthehet popullata e zonës, në mënyrë që të zhvillohet edhe më shumë turizmi dhe të rikthehet jetë e re në këto vende të lashta historike, tha nënkryetari i Sh.A.D.

Çdo zonë ka bukuri mahnitëse dhe resurse të shumta natyrore, duke përfshirë bimët mjekësore, blegtorinë dhe pasuritë e tjera që mund të shfrytëzohen për zhvillimin ekonomik.

Me një ndihmë dhe përkrahje nga Qeveria e Tiranës, zona e Dukagjinit do të bëhet një pikë turistike me nam, shumë e frekuentuar nga vizitorë nga e gjithë Evropa, Amerika, Azia etj.

Qytetarëve do t'u kthehet identiteti, sepse këta qytetarë të kësaj zone janë bujarë, mikpritës, të dashur dhe unikë.

Në këtë manifestim u shtrua një darkë dinjitoze nga nikoqiri i restorantit, Kolë Gjoni, i cili priti dhe përcolli me dashamirësi të gjithë të pranishmit në këtë festë madhështore, "Dita e Rinisë Dukagjinase".

Ky është një manifestim që tash e tutje Rinia e Dukagjinit do ta festojë çdo vit, me shpresën se organizimi i këtij manifestimi kulturor do të përkrahet dhe financohet nga shteti shqiptar, nga Ministria e Kulturës apo nga Zyra e Kryeministrit të Shqipërisë, si dhe të përfshihet në kalendarin zyrtar të aktiviteteve kulturore shtetërore.

Dukagjini nuk duhet të mbetet në harresë. Ai është një pasuri e çmuar e Shqipërisë, një thesar i natyrës, historisë, kulturës dhe traditës shqiptare. Ta mbrojmë, ta zhvillojmë dhe t'ia kthejmë jetën që meriton .

Kumrie Avdyl Shala,
dukagjinase nga Peja e Dardanisë

Një parajsë e vogël ky shpirti gjen qetsinë

"Shtegtar ndalu në këtë shesh e Lute - Të falem Mari Hirplote. Pusho pak e merre bekimin e Zojës e të Shna Ndout"- Don Vlash Palaj

Në zemër të Shalës, buzë Lumit në krye të Ures, buzë rrugës e afër spitalit një parajsë e vogël ky shpirti gjen qetsinë.

Ishte ma parë një Kapel (vend lutje) e Shna Ndout ku koha e frymzuar prej "kjoftlargut" e rrënoj. Në kufirin e harresës, ngallnjeu Drita mbi Terrin. U rrikthye truporja e Shna Ndout, pastaj Zoja (Pieta) dhe basorelievi I Kishës tashmë i gllendur në gurë. Sot Zoja u kthye me Krishtin në preher… Nuk e ndaloj Oqeani as koha plot zhurmë Gjin Markaj që sot me zemrën plot ti thotë Zotit e Zojës FALEMINDERIT. Thellë në shpirtin e tij një za buçet- Nanë ta solla Zojën që në çdo vuajtje dhe sakrific ti s'ja ndave syte as lutjet. Gjini së bashku me nanën e tij kujton të gjitha nanat dukagjinase që sakrifikuan dhe falen Dashni në vuajtje si Zojae Bekueme.

Me 26 Shtator 2026 në Breg Lumit të Shalës Gjiin Markaj reralizoj ëndrrën e tij të kahershme duke i kushtuar vuajtjes dhe dhimbjes së nënës tij e krejt nënave të Dukagjinit truporen e Zojës me Krishtin në preher "Pieta"me rastin e vitit Jubilare të Nënës së Këshillit t'Mirë.. Gjithashtu sheshi në ballë të Urës së Shalës u kompletua edhe me basorelievin ku ishte gllendur Kisha e Shna Ndot e skaltura nga mjeshtri Zef Muri, dhe struktura metalike me emertimin e Kishes punuar Miri Mirashi.

Dita filloj me mikprijen e famijarëve, miqve e dashamirëve të ardhur nga e gjithë Shqiperia e diaspora. Në orën 11. 00 u kremtua Mesha e Shenjtë nga Don Vlash Palaj, famullitari Pader Kastriot Dema, Pader Kolë Mirti, Pader Tom Bushprenaj. Kori i Katedrales i drejtuar nga Maesto. Lukë Mllugja shoqeroj Meshën e Shenjtë. Të pranishëm ishin edhe Shoqnia e Shën Franceskut nga Shkodra.

Pastaj u bekuan nga Pader Kolë Mitri truporja e Zojës, bazorelieve dhe harku metalik. Referuan Padër Kola, Mark Rupa, Nën/Kyetar i Bashkisë Koplik, Sytki Ndreca, Deputetja Marjana Koçeku dhe Gjin Markaj. Aktiviteti u modera nga Mark Rupa. Të pranishmit u ftuan nga Gjin Markaj për të bashkënda drekën në Theth tek Resorant "Zemra e Alpeve" me pronar Dedë Pjetra.

Ja shtuan bukurin aktivitetit e shoqeria e shkolles dhe punës së Gjinit dhe Kori i Katedrales me këngët e tyre. Tashmë banor të Shalës dhe kalimtare në Breg Lumit, aty në ballë të Urës e marrin bekimin e Zojës së bekuar dhe Shna Ndout. Sot Gjin Markaj falenderues ndaj Zotit dhe i lumtur merr falenderimin nga të gjithë të pranishmit e krejt Dukagjinin për kontributin e dhënë gjatë gjithë këtyre viteve për Dukagjinin. Sot Gjini mori edhe bekimin e Zojës së bekuar dhe të gjithë nënëve Dukagjinase, Martire të Fesë e Dashnisë.

Roza Pjetri

NË VIJIM
MBERSA NGA KJO VEPRIMTARI

Nga Nen/Kryetri I Bashkisë Koplik Sytki Ndrecaj

Një ditë mirënjohjeje e vlerësimi ndaj ftesës së shokut tonë Gjin Markaj për të takuar njëri-tjetrin e për ti dhënë bekimi shoqërisë tonë në 41 vite të fillimit të njohjes e të forcimit më tej e që buron nga Universiteti Bujqësor I Tiranës. Me këto ndjenja u bëmë së bashku tok me Ajen Grabovaj, Rifat Mulaj, Idriz Gjini, Shefqet Beqirir e Zef Gjeta e me bashkëshortet e njerëzit e tjerë të afërm që plotësuan gjithë respektin e duhur.

"Nderi lahet me nder" themi ne shqiptarët, ndaj edhe u nisëm me obligim të madhë për të ndarë me Gjinin e të afërmit e tij Markaj vazhdimin e veprave humane e shpirtërore (je vetëm këto) për të gjithë banorët e Breg Lumit, Shalës e Dukagjinit siç ishte vendosja e shtatorës së Zojës Mari pas vendosjes së Shtatorës së Shna Ndout.

Ne jemi vëllezër e shokë, shqiptarë të nderuar e të shpërndarë në shumë treva të Shqipërisë por që kemi një Zot që na bashkon një qëllim i shejtë ruajtja e unitetit, besimin në vlerat njerëzore e humane ku madhështia ndihej tek të gjithë ne.

Me ritet fetare në Kishën e fshatit e me perurimin e shtatorës në fjalë ne e kishim humbur lodhjen nga rruga e gjatë, na ishte mbushur frymëzimi se po përmbushim një ditë të bukur e me plot shpresa për të ardhmen tonë e familjeve tona e në emër të gjithë shokëve e shoqeve tona tashmë shpërndarë nëpër zona, treva e vende të ndryshme të botës, por edhe me mbrojtjen e engjëjve të atyre që na shohin nga qielli e të ndarë nga jeta prej vitesh.

Pas momenteve të perurimit dhe bekimit nga Dom Vlash Palaj një prift mjaft miqësorë e intelektual dhe në mesin e përshëndetjeve të rastit e mora fjalën edhe unë ku në emër të shokëve e shoqeve i përshëndeta të pranishmit e shumtë duke uruar Gjinit për mbështetjen që i jep vendlindjes së tij e Dukagjinit në tërësi e në rastin konkret për afrimin shpirtërorë nëpërmjet vendit të shenjtë dhe rritjen e pelegrinazhit jo vetëm si ndjenjë besimi fetarë por edhe si atraksion turistik përballë edhe gjithë kësaj mrekullie natyrore e dhënë nga Zoti dhe me investimet infrastrukturore që ishin bërë e që do të bëhen edhe në të ardhmen për këtë zonë.

Faleminderit të gjithëve për mikpritjen e bujarinë e treguar e sidomos shokut tonë Gjin Markaj duke uruar që Zoti t'ia shpërblejë me të mira në jetë e shëndet atij e familjes tij së bashku.

Nga, Agron PREBIBAJ

Viti jubilar/ NGJITET NË DUKAGJIN TRUPORJA E ZOJËS MARI

Gjin Markaj, rrit kopshtin e altarit të shënjëtorëve. Nderon nënat!

Pasi Vatikani shpalli 2026-ën, "VITI JUBILAR I ZOJËS SË KËSHILLIT TË MIRË", menjëherë përsonaliteti mendje dashur për vëndlindjen zt.Gjin Markaj nga Amerika, ka ndigjuar shpirtërisht e menduar nderimin për nënën, për nënen Shaliane, atë Dukagjinase e për nënat shqiptare, duke vëndosur ngjitjen e trupores së Zojës Bekuar në kopshtin e altarit të shënjetorëve në Shalë.

Dukagjini, në të gjitha etapat historike orëmadh, shqiptari më identitar, i kalitur ndër shekuj, më mendimtarë e prinjës në rezistenco - qëndresën e përjetësisë, e cila po deshmon edhe sot me përcjelljen nga brezat, me potencialet intelektuale e deri te dorëzimi i portofolit për vëndlindjen.

Udhëtimi im nga Tirana së bashku me zt. Gjin e Sokol Niklekaj, madje u bashkuam edhe me Av.Ndoc Pepçi, ishte një udhtëm i lehtë e shumë i ngohtë drejt kryeqenderës së Dukagjinit, Breg Lumi - Shalë, aty për tu mbushur me adrenalinen miqësore e vllazërore në këtë ditë historike, aty unë kam lidhjen shpirtërore e miqësore ndër breza, ndaj dhe ndihem si në shtepinë time, vetëm aty më mundësohet të jem edhe "mbret".

Me të arritur, fillimisht e nisem te kisha e Shalës, te hyrja u mirëpritem nga i zoti i shtëpisë zoti Gjin Markaj, pastaj gjithçka sipas rregullave, u futem të gjithë në meshën e shënjtë e drejtuar nga Dom



Shqiptari i parë në Belgjikë

Perkujtohet 70 vjetori i mberritjes se shqiptareve te pare ne Belgjike. Shumica e tyre i perkasin Dukagjinit dhe Veriut te Shqiprise.

Komuniteti Shqiptar ne Belgjike ka perkujtuar 70 vjetorin e mberritjes se grupit te pare te emigranteve ne stacionin e trenit Ardenne. Ata u priten nga Karitasi i Belgjikes dhe autoritetet belge. 1 gusht i vitit 1956, eshte data simbolike ku mberriten emigrantet e pare ne token belge. Jane 700 emigrante ku nga te cilet 350 shqiptare vinin nga Kampi i Geroves ne Kroci ne ish Jugosllavie.

Ishin emigrante nga Dukagjini, Puka, Kukesi, Dibra qe kishin kaluar kufirin ne periudha te ndryshme nga viti 1945-1948, por gjithashtu ishin dhe emigrante nga zonat rurale qe kishin emigruar si familje e individe. Mberritjes e shqiptareve ne Belgjike ne vitin 1956 i perkiste trazirave te botes komuniste dhe ndryshimeve ne Bashkimin Sovjetik. Keto familje kishin perjetuar kushte te veshtira ne kamp. Ne vitin 1956, shumica e tyre mori statusin e refugjatit nga OKB-ja me Konverten e Gjeneves. Keto familje u priten nga Karitasi i Belgjikes e Kisha Katolike duke i sistemuar me ushqime, veshmbathje e me strehimin e tyre. Keto familje u vendosen ne komunat Schaerbeek, Bruksel, Namur. Ne kete grup benin pjese dhe familje shqiptare te Kosoves qe kishin emigruar ne Turqi dhe Itali. Kishte figura te shquar si Fiqiri Dini kryeminister i vitit 1944, Muharrem Bajraktari gjenerali i gjendermarise se mbretit Zog dhe Kolonel Prenk Pervizi. Familje te tjerat ishin amilja Thana (Ulaj) me 16 antare nga Dushmani dhe familja Kukaj nga Raja, qe gjithmone deklaruan origjinen e tyre Dukagjinin.





Sistemi komunist il quand gamiljet e arratisura "te prekur" te folen e vujten shume pjestaret e familjes se mbetur ne Shqiperi duke i derguar ne kampe internimi, duke i hequr trisken e frontit demokratik, si dhe ju ndalohej e drejta per te vazhduar shkollen e mesme. Ajo qe i karakterizon shqiptareve e brezin e katert sot eshte ruajtur e gjuhen, tradites familjare duke u integruar qete ne shoqerine belge. Ato ndiejen mirnjohje per Karitasin e Belgjikes per ndihmen e afruar. Sot mjaft pjestare te ketyre familjeve jane integruar ne jeten politike, akademike, shkencore, kulturore e profesionale te Belgjikes.

70 vjet kujtese dhe mirnjohje per te zgjedhurit shqipetare si deputetia Kristela Bytyqi, keshilletarja Laura Lita, ambasadori shqiptar Gazmend Barbullushi. Nje pune e madhe ne keto vite eshte botimi i librit "Pourquoi la Belgique dans l'histoire albanaise?" me autor studiuesin Gjovalin Kola dhe nje revistr et botuar nga Kol Gjeloshaj Hysaj e Fran Kukaj.

ZEF NIKA, *Bruksel.*

Ndahet nga jeta agronomi i pare i Shllakut Martin Luk Zhuri



Keto dite eshte ndar nga jeta ne Itali Martin Luk Zhuri nga Gegajt e Shllakut. Martin Zhuri do te mbetet ne kujtese si spécialist i pare nga Shllaku i diplomuar ne Universiteti Bujqesor, Tirane ne degen Agronomi e pergjithshme. Martini vinte nga nje familje e varfer por e nderuar e Luk Geges. Pas mbarimit te fakultetit, ai u emrua ne Kooperativen Bujqesore Shllak. Punoi ne te gjithe sektoret e koopratives duke njohjur çdo pjese toke te çdo fshati.

Zona e Shllakut ishte nje kooperative me siperfaqie toke te kufizuar, por au arriti te ndertoj skema te reja si kultuvimi i qepujkes dhe perimeve. U shqua per ndershmeri e korrektesi, si dhe dallohej nga kuadrat qe kishin ardhur si aksionista e me vone nga kuadra drejtues. Nuk ishte angazhuar ne parti dhe asnjehere nuk u emerua kryeagronom. Ne fund te mberimit te sistemit koopravist u emerua Kryetar Kooperative i Shllakut. Respekt per kete njeri te ndershem qe do te mbese ne kujtese si agronomi i pare me shkolle te larte e kryetar i fundit i Koopratives ne Shlak.

Ngushllime familjes e te afermeve.



Vlash Palaj me freter të tjerë, shoqërohej edhe nga muzika e një trupe të kishes katolike Shkoder, kjo mesha e ndjekur përzemersisht nga intelektualët myslimanë nga krahinat shqiptare të ftuar si miq në këtë festë.

Pas meshës ju drejtuam Bregut të lumit, aty ku vite më parë Gjin Markaj ka nisur kopshtin e altarit të shenjëtorëve; fillimisht me Truporen e Shna Ndout, pllakatat historike, memorialo - tribunali i martirëve të kishës katolike etj, ku sot i vjen rradha nënës së Jezusit, aty sot vjen Maria e bekuar.

Z.Gjin Markaj së bashku me priftin e Shalës zbuluan Truporën e Zojës bekuar Mari me Krishtin, një ceremoni e cila u përcoll me ngohtësi nga pjesëmarrësit.

Përshendetën duke sjellë mesazhe njerëzore disa përsonalitete, foli Dom Vlashi, z.Sytki Ndrecaj - n/kryetrari i Bashkisë Malësi e Madhe, përshendeti përsonaliteti Gjin Niklekaj, deputetja znj.Marjana Koçeku, administratori i Nj.Administrative Shalë z.Prek Doçi, për të vazhduar me mesazhet ngohëse nga moderatori z.Mark Rupa etj.

Ndërsa i zoti Gjin Markaj e përmbylli me fjalë që të japin adrenalinë, fjalë zemre e urim për nënat shaliane, dukagjinase e për të gjitha nënat shqiptare, duke uruar bekimin e kombit shqiptarë, sot në këtë ditë të bekimit të truporës së Shen.Marisë në Shalën tonë historike, thesari që pasuron identitetin tonë kombëtarë.

Aty ishin me zemer të gjithë dukagjinasit, por ishin plotë e folën e gëzuan të gjithë, ata kanë sjellur mesazhet e tyre njërëzore, por pse jo edhe mesazhet e krenarisë në qëndresën identitare shekullore.

Gjithçka e organizuar mrekullisht e përmbyllur me drekën në Theth për miqtë e ftuar me 26 shtator 2026.

Largohemi me kokën pas nga kjo ditë e veçantë dhe e bekuar, për Dukagjinin e sherbesë kombëtare, pasi sot në këtë botë jo pak të trazuar kemi nevojë për disa Gjin Markaj si komb, i cili apelon për familjen e shënjtë e besimin në Zot, të cilat dhurojnë individ të fortë, shoqëri të shëndoshë e shtet të fortë.

Tashmë kopshti i altarit me shenjëtorë, i formatuar e ndertuar nga burrëmadhi dukagjinas zt.Gjin Markaj një përjetësi përcjellje identiatare e kombit shqiptarë.

Zoti e bekoftë përsonalitetin Gjin Markaj, për mrekullitë hyjënore që na sjell me krenari për vëndlindjen e kombin.

ZEF DODA, LIS I MADH I ARSIMIT E HISTORISË KOMBËTARE

Av.Sokol Dedndreaj, nderoi babain, bashkoi elitën kombëtare !

Me 3 tetor 2026, salla Balsha në Tirana Intrenacional është pushtuar si rrallë herë nga intelektualët e kombit shqiptar, për të kujtuar, nderuar e zbardhur veprën e Lis-Madhit të arsimit në Nikaj-Mertur e Dardani zotit Zef Doda si misionar i arsimit kombëtar.

Organizatori i ketij Smpoziumi Shkencor e nderimi ishte i Av.Sokol Dedndreaj me familjarët e vet, i cili mbushi plotë sallën Balsha me elitën kombëtare, aty ishin intelektualët e Nikaj-Merturit, Malsia e Gjakovës, nga gjitha trojet shqiptare, aty ishte i gjithë kombi me artistë, profesorë, gazetarë, klerikë e intelektualë të gjitha fushave.

Gjithçka e ideuar e formatuar mjeshtërisht nga i zoti i shtëpisë zt.Sokol Dendreaj, e cila nis me hymnin kombëtar, telereportazhin kryeveper me një skenar mjeshtror, i cili na tregoi thesarin e mësuesit e historianit Zef Dode Dedndreaj.

Për kalorsin e arsimit në shqiptari kumtuan plotë personalitete të arsimit, kulturës e historisë shqiptare.

Zt.Sokol Dedndreaj i jemi mirënjohës që na solli shëmbullin e nderimit për babain, por me këtë Simpozium kujtese, Ai nderoi Nikaj-Mertirin, Malësinë e Gjakovës, Dukagjinin e gjithë kombin, me mesazhin e percjelljes te brezat të burrave tanë kollos të arsimit e historisë si thesari i çmuar për kombin shqiptarë.

Zef Doda, përsonalitetit i madh i dijes, arsimit, studiues e historian, burri që ndriçoi hisorinë e Nikaj-Merturit, Malësisë Gjakovës dhe Dukagjinase nepermjet fakteve e dekomentave historike, sherbëtori i identitetit tonë kombëtarë.

Agron Prebijaj

Kumtesa e Dr.Dedë Qokaj

ZEF DODA, MËSUESI E HISTORIANI, QË SHERBEU KOMBIT.

Zef Doda, historiani që sherbeu kombit në faktet historike të identitetit tonë kombëtarë. ef Dodë Dedndreaj – mësuesi, drejtuesi dhe formuesi i burimeve njerëzore vendase. Kontributi i tij në zhvillimin e arsimit dhe kulturës nikajmërturase

1. Hyrje

Historia e një krahine nuk shkruhet vetëm nëpërmjet ngjarjeve politike, përpjekjeve ushtarake, dokumenteve administrative apo veprave të personaliteteve të mëdha. Ajo shkruhet edhe në klasat e shkollave, në duart e mësuesve, në fletoret e nxënësve dhe në rrugën që një brez bën nga analfabetizmi drejt dijes. Konkretisht, në rastin e Nikaj-Mërturit, ky proces ka një rëndësi të veçantë.

E ndodhur në një hapësirë malore, me vendbanime të shpërndara dhe me komunikim të vështirë, shkollat e trevës nikajmërturase u përballën për një kohë të gjatë me mungesa infrastrukturore, materiale dhe njerëzore. Në këto kushte, hapja e shkollës nuk ishte e mjaftueshme. Problemi kryesor ishte krijimi i një kulture të qëndrueshme shkollimi. Në këtë proces, mësuesi merrte një rol shumë më të gjerë se ai i transmetuesit të njohurive, si: organizator, këshillues, edukator, zbulues i talenteve dhe, shpesh, ndërmjetës midis familjes, shkollës dhe komunitetit. Kjo është arsyeja pse figura e Zef Dodë Dedndreajt meriton të studiohet jo vetëm si një figurë individuale, por si pjesë e historisë së arsimit nikajmërturas, ngaqë kontributi i qëndrueshëm i Tij në arsimin e Nikaj-Mërturit nuk qëndron vetëm në vitet e shumta të punës si mësues, por në rolin që luajti në krijimin e një tradite të re arsimore dhe në formimin e kuadrit vendas.

2. Formimi i hershëm: nga nxënës i At Bernardin Palajt te mësuesi i Malësisë

U lind në Salcë të Mërturit në vitin 1923, tek i cili familja dhe mjedisi ku u rrit, patën ndikim në formimin e tij. Materiali biografik e lidh këtë formim me një familje me tradita patriotike dhe me një jetë të ndërthurur me dijen, luftën kundër analfabetizmit dhe përpjekjet për zhvillimin kulturor të malësorëve. Në vitin 1928, në kishën e Palçit, ai mori mësimet e para të shkrimit dhe leximit nën kujdesin e At Bernardin Palajt, një fakt me rëndësi simbolike dhe historike.

Ai që më vonë do t'u mësonte brezave të Nikaj-Mërturit rrugën e dijes, e kishte nisur vetë atë rrugë në një mjedis ku shkolla dhe kultura ishin ende të kufizuara.

Në vitin 1937 fitoi të drejtën për të ndjekur Normalen e Elbasanit. Atje u përball me një mjedis të gjerë arsimor dhe intelektual dhe u dallua për sjellje e përparim. Këtu pati njohje të drejtpërdrejtë me nxënës që vinin nga dyer të para të bajraqeve të kohës dhe trevave të ndryshme të Shqipërisë, si: Kasëm Trebeshina, Irfan e Baftjar Ndreu, Hasan Mërlika, Gjokë Jaku, Pal Nikollë Prendi etj.

Në vitet 1943–1944 vazhdoi studimet në Kolegjin Saverian të Shkodrës, me bursë të akorduar nga ministri i Arsimit Ernest Koliqi. Kështu, formimi i tij nuk ishte thjesht vendor. Ai u edukua në disa prej institucioneve më të rëndësishme arsimore shqiptare të kohës dhe më pas u kthye në Malësi. Ky kthim përbën një moment themelor të biografisë së tij: dija e fituar jashtë vendlindjes u vu në shërbim të vendlindjes.


3. Viti 1946: kthimi në Salcë dhe fillimi i misionit pedagogjik

Në vitin 1946, Zef Doda nisi punën si mësues në shkollën e Salcës. Sipas të dhënave biografike, në fund të atij viti ai u njoftua për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, me formulimin se ishte "i padëshiruar". Në vitin 1949 ai u rikthye në profesionin e mësuesit në Salcë dhe punoi aty për katër vjet. Kjo periudhë është e rëndësishme sepse tregon se veprimtaria e tij pedagogjike nuk kufizohej në mësimin formal.

Ai organizoi: rrethe shkollore, kurse jashtë klase, veprimtari sportive, aktivitete edukative, forma të ndryshme të angazhimit të nxënësve. Ndaj që në fazën e parë të karrierës së tij shfaqet një ide pedagogjike që do ta shoqërojë gjatë gjithë jetës: shkolla duhet të jetë qendër e jetës kulturore të komunitetit.

4. Viti 1953: Gjonpepajt dhe një përgjegjësi e re

Viti 1953 përbën një pikë kthese në veprimtarinë e Zef Dodës. Me hapjen e shkollës së parë 7-vjeçare në Gjonpepaj, ai u emërua drejtor i saj dhe njëkohësisht drejtues i shkollave të zonës së Nikaj-Mërturit. Ky nuk ishte më vetëm një funksion mësimor. Ai përfaqësonte një përgjegjësi të re: organizimin e arsimit në nivel zone. Për një territor malor, kjo kërkonte jo vetëm njohuri pedagogjike, por edhe aftësi organizative. Shkolla e Gjonpepajve duhej të funksiononte si qendër; mësuesit duhej të orientoheshin; nxënësit duhej të motivoheshin; familjet duhej të bindeshin për rëndësinë e shkollimit; ndërsa shkollat e tjera duhej të lidheshin në një sistem të përbashkët. Në këtë kontekst, roli i Zef Dodës mund të përkufizohet në tri nivele: mësues – drejtues dhe organizator i arsimit zonal.



5. Rrethet metodike: krijimi i një kulture profesionale

Gjatë drejtimit të shkollës së Gjonpepajve, Zef Doda ngriti rrethe metodike, të cilat u bënë shembull edhe për shkolla të tjera të rrethit. Ky element meriton vëmendje të veçantë. Rrethi metodik nuk ishte thjesht një strukturë formale. Ai krijonte mundësinë që mësuesit të diskutonin: përvojën e tyre, mënyrat e mësimdhënies, vështirësitë e nxënësve, format e kontrollit dhe vlerësimit, aktivitetet edukative, përvojat e suksesshme. Në një zonë ku shumë probleme pedagogjike duhej të zgjidheshin me mjete të kufizuara, bashkëpunimi profesional kishte rëndësi të veçantë. Këtu qëndron një nga kontributet më të rëndësishme të Zef Dodës: ai ndihmoi që mësuesi i Malësisë të mos ishte një individ i izoluar, por pjesë e një komuniteti profesional.

Kjo ishte një bazë e rëndësishme për rritjen e cilësisë së arsimit.

6. Nga shkolla e Gjonpepajve te rrjeti arsimor i Nikaj-Mërturit

Veprimtaria e Zef Dodës duhet parë brenda një procesi më të gjerë. Gjonpepajt nuk ishin një ishull i izoluar arsimor. Në vitet e mëvonshme, rrjeti shkollor u shtri dhe u konsolidua në disa qendra të krahinës. Në vitin 1960 Zef Doda u transferua në Shëngjergj, ku funksiononte një strukturë shkollore me shkollat vartëse të Tetajt, Bëtoshës dhe Currajve të Poshtëm. Atje qëndroi pesë vjet. Kjo periudhë e zgjeron më tej dimensionin e punës së tij. Ai nuk kishte më përballë vetëm një shkollë. Kishte një territor arsimor. Kjo kërkonte të njëjtën kohë: organizim, kontroll, orientim, motivim dhe kujdes për nxënësit.

7. Misioni kryesor: krijimi i kuadrit vendas

Këtu ndodhet, sipas vlerësimit tonë, thelbi i kontributit të Zef Dodë Dedndreajt. Sipas materialit burimor, gjatë punës në Shëngjergj ai nxiti dhe ndihmoi qindra të rinj që të vazhdonin studimet, me synimin që një ditë të ktheheshin si intelektualë në zonën e tyre. Për rezultatet e kësaj pune, ai u angazhua edhe në kontrolle në shkollat e rrethit, ku identifikonte të rinjtë e talentuar dhe i orientonte drejt arsimit të mesëm dhe të lartë. Ky është momenti ku figura e Zef Dodës kalon nga historia e mësuesit në historinë e zhvillimit njerëzor të krahinës. Ai nuk pyeste vetëm: "Sa nxënës po mësojnë?" Por, në thelb, pyeste: "Cilët prej tyre mund të bëhen nesër mësues, intelektualë dhe kuadro të krahinës?" Ky ndryshim perspektive është thelbësor. Një shkollë mund të japë dije për një brez. Por një sistem arsimor që formon kuadër vendas mund të ndryshojë strukturën kulturore të një komuniteti për dekada.

8. "Kuadri vendas" si rezultat historik i arsimit

Në vitin 1962, zona e Lekbibajve u dekorua me Urdhrin e Klasit II, e lidhur kjo me faktin se lokaliteti kishte siguruar kuadrin vendas. Rëndësia historike e procesit është e qartë: Nikaj-Mërturi po kalonte nga një fazë ku arsimi varej kryesisht nga mësues të ardhur nga jashtë, drejt një faze ku vetë krahina po prodhonte njerëzit e saj të arsimuar. Dhe ky është pikërisht procesi në të cilin Zef Doda luajti një rol të rëndësishëm. Në këtë kuptim, ai ishte jo vetëm mësues i fëmijëve të Nikaj-Mërturit. Ai ishte, në një masë të rëndësishme, formues i brezit që do të mbante mbi supe të ardhmen arsimore të krahinës.

9. Zef Doda si "zbulues talentesh"

Një aspekt veçanërisht interesant i veprimtarisë së tij është angazhimi në evidentimin e nxënësve të talentuar. Në kuadër të kontrolleve në shkollat e rrethit, ai "gjurmonte të rinjtë e talentuar" për t'i drejtuar drejt arsimit të mesëm e të lartë. Në kushtet e një krahine malore, kjo kishte një rëndësi të jashtëzakonshme. Një fëmijë i talentuar mund të humbiste lehtësisht mundësinë e shkollimit për shkak të: varfërisë, largësisë, mungesës së informacionit, vështirësive familjare, mentaliteteve tradicionale, mungesës së një modeli të afërt intelektual. Prandaj, puna e mësuesit ishte edhe ta shihte talentin, ta nxiste dhe ta orientonte. Kjo është një nga dimensionet më humane të veprimtarisë së Zef Dodës.

10. Arsimi si emancipim shoqëror

Në këtë pikë duhet parë edhe marrëdhënia ndërmjet shkollës dhe shoqërisë tradicionale. Të dhënat biografike mbi Zef Dodën e përshkruajnë punën e kësaj periudhe si një përpjekje të zhvilluar në kushtet e vështirësive të mëdha dhe të zakoneve tradicionale që ende kishin ndikim të fortë në Malësi. Shkolla, pra, nuk ishte vetëm institucion i dijes. Ajo ishte edhe hapësirë e ndryshimit shoqëror.

Nëpërmjet shkollës: fëmija dilte nga kufijtë e ngushtë të komunitetit, fitonte njohuri të reja, mësonte të lexonte e të shkruante, njihej me historinë dhe kulturën, krijonte ambicie për arsimim të mëtejshëm, krijonte mundësi për një profesion tjetër nga tradita familjare. Në këtë proces, mësuesi ishte një figurë kyçe. Zef Doda e kuptoi këtë që herët.

11. Arsimi dhe formimi i brezave: dëshmia e Anton Paplekës

Një mënyrë e rëndësishme për të matur ndikimin e një mësuesi është të kërkohet gjurma e tij në kujtimet e ish-nxënësve. Një dëshmi e tillë lidhet me poetin dhe studiuesin Anton / Ndoc Papleka. Sipas një kujtimi të botuar për të, Papleka ndoqi shkollën 7-vjeçare në Gjonpepaj dhe ruante kujtime për mësuesit e tij, ndër ta edhe Zef Doda. Po në këtë shkollë u krijua edhe një rreth letrar që ndikoi në nxitjen e tij drejt krijimtarisë. Kjo dëshmi është e rëndësishme, sepse na lejon të shohim një pasojë konkrete të shkollës: ajo nuk prodhonte vetëm nxënës që dinin të lexonin e të shkruanin; prodhonte edhe njerëz që nisnin të mendonin, të krijonin dhe të shkruanin. Kështu, historia e Zef Dodës, lidhet edhe me historinë kulturore të brezave të rinj të Nikaj-Mërturit.

12. Formimi i vetë mësuesit: diploma në "Gjuhë-Histori"

Një paradoks i bukur i jetës së tij pedagogjike është se, ndërsa nxiste të rinjtë të vazhdonin shkollimin, ai vetë vazhdonte të formohej. Pas tri vitesh studimi me korrespondencë, në vitin 1961 u diplomua në Institutin Pedagogjik të Shkodrës, në degën "Gjuhë-Histori", duke u kualifikuar si mësues i gjuhës dhe historisë për shkollat 7-vjeçare. Kjo tregon një parim të rëndësishëm: mësuesi që formon të tjerët duhet të vazhdojë të formojë veten. Në një zonë të largët nga qendrat universitare, studimi me korrespondencë kërkonte përkushtim të veçantë. Kështu, zhvillimi i arsimit në Nikaj-Mërtur nuk ishte vetëm proces i nxënësve. Ishte edhe proces i vazhdueshëm i formimit të mësuesve.

13. Nga mësuesi te intelektuali i komunitetit

Veprimtaria e Zef Dodës nuk përfundonte në shkollë. Në vitet e mëvonshme ai u angazhua edhe në ngritjen e muzeut të lokalitetit Lekbibaj, në hartimin e historikut të Nikaj-Mërturit dhe në punën për historikun e Tropojës. Në vitin 1980, iu aprovua maketi i historikut të Nikaj-Mërturit, mbi bazën e të cilit u krijua muzeu historik i zonës. Ai gjithashtu mori pjesë në një sesion shkencor të zhvilluar në Lekbibaj dhe punoi në komisionin për projekt-historikun e rrethit Tropojë. Kjo veprimtari tregon se për të arsimi nuk mund të ndahej nga kujtesa historike. Një popull që mëson të lexojë, duhet të mësojë edhe të lexojë historinë e vet. Këtu Zef Doda shfaqet si një ndërlidhës midis dy botëve: mësuesit dhe studiuesit.

14. "Nikaj-Mërturi – Vështrim historik": nga klasa te kujtesa e shkruar

Një dëshmi e rëndësishme e këtij dimensioni është vepra "Nikaj-Mërturi - Vështrim historik", me bashkautorë Dodë Progni dhe Zef Doda. Vepra është ribotuar në vitin 2024 dhe është cilësuar si një kontribut me rëndësi për njohjen e krahinës së Nikaj-Mërturit dhe zonave përreth. Ky aspekt është i rëndësishëm për kumtin tonë. Mësuesi që për dekada kishte punuar me brezat e rinj, në një fazë tjetër të jetës së tij u angazhua edhe në dokumentimin e historisë së vendit. Kjo krijon një vijimësi: mësuesi → nxënësi → intelektuali → studiuesi → kujtesa historike.

Në këtë kuptim, vepra historike nuk duhet parë si një veprim i shkëputur nga veprimtaria e tij pedagogjike. Ajo është vazhdim i saj. Nëse në klasë ai u mësonte nxënësve të lexonin, në shkrimet e tij për krahinën ai përpiqej t'i jepte komunitetit një tekst ku të mund të "lexonte" historinë e vet.

15. Mësuesi si ndërmjetës i kujtesës

Nikaj-Mërturi ka një trashëgimi të pasur të traditës gojore, historisë së fiseve, vëllazërive, zakoneve dhe figurave vendore. Në një shoqëri ku një pjesë e madhe e kësaj trashëgimie transmetohej gojarisht, shkolla dhe shkrimi fitonin një funksion të ri. Ata bëheshin mjete për ruajtjen e kujtesës. Kjo shpjegon edhe angazhimin e Zef Dodës në muze, në historikun e krahinës dhe në kërkimet arkivore. Prandaj, ai duhet parë edhe si një ndërmjetës i kujtesës kulturore. Ai merrte atë që vinte nga tradita dhe përpiqej ta kthente në dokument, tekst, histori dhe material për brezat.

16. Përtej vitit 1980: shkrimtari dhe intelektuali

Më 24 tetor 1980, Zef Doda doli në pension pas 35 vjetësh punë, por pensionimi nuk shënoi fundin e veprimtarisë së tij intelektuale. Pas vitit 1990 ai botoi disa vepra, ndër to: "Mashtrimi", roman (1997); "Kulla e Zjarrit", monografi (1999); "Mësuesi i shkollës Shuk", roman (2001); "Nikaj-Mërturi – Vështrim historik", monografi (2003, ribotuar 2024), me bashkautor; "Gjyq në bunker", novelë, "Pika Loti", tregime; "Sokol Meshi – njeriu i punës", monografi (2005), si dhe vepra të tjera në dorëshkrim që presin dritën e botimit. Burime të botuara për figurën e tij e paraqesin po ashtu si mësues, shkrimtar dhe intelektual të Nikaj-Mërturit. Kjo fazë e jetës së tij është një dëshmi se kultura e shkollës nuk përfundon kur mësuesi del në pension. Ajo vazhdon në krijimtari. Dhe autori na flet nëpër mote me veprën e Tij të larmishme, si trashëgimi arsimore, etnokulturore dhe letrare. Ndaj në shenjë vlerësimi për ndihmesën shumëdimensionale në fusha të ndryshme të dijes njerëzore, Presidenti i Republikës i ka akorduar titullin "Naim Frashëri"; Certifikatë Mirënjohjeje nga Këshilli i Komunës, Lekbibaj dhe bashkia Bajram Curri, si dhe "Qytetar Nderi", po nga kjo bashki në vitin 2026.

17. Përfundime

Nga analiza e materialeve të disponueshme mund të nxirren disa përfundime kryesore:

Së pari, Zef Dodë Dedndreaj i përket brezit të mësuesve për të cilët arsimi ishte më shumë se profesion. Ishte mision.

Së dyti, ai kaloi nga roli i mësuesit në atë të drejtuesit dhe organizatorit të arsimit të një territori.

Emërimi i tij në Gjonpepaj në vitin 1953 shënon një etapë të rëndësishme në këtë zhvillim.

Së treti, puna e tij me rrethet metodike ndihmoi në krijimin e një kulture bashkëpunimi dhe zhvillimi profesional ndërmjet mësuesve.

Së katërti, kontributi i tij më i rëndësishëm ishte nxitja e të rinjve për të vazhduar shkollimin dhe për të krijuar një kuadër vendas të arsimuar.

Së pesti, ai luajti rolin e një "zbuluesi talentesh", duke orientuar të rinjtë e aftë drejt arsimit të mesëm dhe të lartë.

Së gjashti, veprimtaria e tij nuk u kufizua në arsim. Muzeu, historiku i Nikaj-Mërturit, puna me arkivat dhe botimet e mëvonshme tregojnë se ai e pa dijen si një sistem ku arsimi, historia dhe kultura plotësojnë njëra-tjetrën.

Së shtati, dëshmitë mbi ish-nxënësit, si rasti i Anton Paplekës, ndihmojnë për të kuptuar gjurmën e shkollës dhe të mësuesve të Gjonpepajve në formimin kulturor të brezave të rinj.

Burime të drejtpërdrejta:

1. "Zef Dodë Dedndreaj", material biografik nga trungu familjar i autorit i diponueshëm për këtë kumtim.
2. Progni, Dodë – Doda, Zef, "Nikaj-Mërturi – Vështrim historik", Geer, ribotim 2024. Botimi është dokumentuar edhe në njoftimet e vitit 2025 për ribotimin e veprës.

Burime plotësuese:

1. Materiale të botuara mbi historinë e Nikaj-Mërturit dhe zhvillimin e arsimit të krahinës.
2. Dëshmi dhe kujtime mbi shkollën 7-vjeçare të Gjonpepajve dhe mësuesit e saj, përfshirë Zef Dodën.
3. Artikulli "Zef Dodë Dedndreaj – shkrimtari dhe intelektuali i Nikaj-Mërturit", Gazeta "Nacional", 9 mars 2024.

Burime arkivore rekomanduese:

- Arkivi Qendror i Shtetit – fondet e arsimit për periudhën 1945–1980;
- dokumentacioni i Drejtorisë / Zyrës së Arsimit të rrethit Tropojë;
- dokumenti origjinal i dekorimit të vitit 1962 për kuadrin vendas;
- dokumentet e emërimit të Zef Dodës në Gjonpepaj;
- dokumentet e rretheve metodike;
- dokumentacioni i historikut të Nikaj-Mërturit;
- materialet e muzeut historik të Lekbibajt;
- dosjet arkivore që lidhen me veprimtarinë pedagogjike të Zef Dodës.

Turizmi masiv në Theth dhe pasojat e tij shkatërruese



Prof.Dr. Perikli Qirjazi
Drejtuesi i Njësisë Kërkimore Gjeografike, në Akademinë së Shkencave të Shqiperisë.

Kriza e Thethit Nisur nga ngjarjet e rënda të Thethit, te cilat flasin për krizën e turizmit në këtë fshat, por edhe në qendrat e tjera turistike, pa pretenduar për një analizë shteruese të shkaqeve dhe rrugëve të zgjidhjes, që kërkon ndihmesën e shumë studiuesve, desha të shprehem rreth kësaj krize, duke vënë theksin në aplikimin e gabuar të turizmit shkatërrues masiv, rezultat sidomos i mungesës së studimeve të thelluara e gjithëpërfshirëse, i strategjive dhe programeve shkencore zhvillimore, i zbatimit të ligjeve në fuqi e të tjera. Gjithsesi theksoj se është tepër i gabuar momenti i ndërhyrjes së shtetit, duke shkatërruar të gjitha ndërtimet pa lejë, tani në mesin e sezonit turistik, midis turistëve të shumtë. Kjo duhet të ishte bërë kohë më parë, kur ndërtoheshin, apo të paktë jashtë sezonit turistik. Ku ishte kryeplaku i fshatit, kryetari i njësisë administrative, bashkia e qarku Shkodër, IKMT, vetë shteti? Pse e lejuan ata këtë masakër mjedisore dhe sociale? Funksionimi normal i këtyre strukturave, do ta kishte evituar këtë krizë, këtë stres të madh të banorëve të Thethit, të cilët, me mundin e djersën e tyre, investuan për një jetë më të mirë, për të ardhmen e tyre; do të evitonte këtë konflikt me shtetin e tyre. Nga ana tjetër, unë i siguroj gjithë investuesit thethjanë se nuk është kjo rruga e zhvillimit të turizmit në fshatin e tyre, i cili meriton një turizmë të qendrueshëm, në harmoni me vlerat natyrore, historike e sociale; u them atyre se kursesi nuk duhet të shkelet ligji dhe të ndërtoni pa lejë edhe pse jeni në tokën tuaj, të cilën ta gëzoni dhe ta trashëgoni në breza. Në respekt të stresit të shkaktuar nga humbja e investimit, do t`iu them se zhvillimi, duke respektuar ligjin, mjedisin natyror e social, peizazhin e mrekullueshëm alpin të parkut kombëtar, është e vetmja rrugë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të sigurt të turizmit, për ata dhe për brezat pasardhës. Natyrisht, për këtë zhvillim ata domosdoshmërisht duhet të mbështeten nga shteti, jo me fjalë, por me financime, politika të studiuara zhvillimore, me infrastrukturë bazë etj. * * * Natyrisht, është i mirëpritur nga të gjithë zhvillimi i turizmit në vendin tonë, në malet tona, në zonat e mbrojtura, sidomos në Alpet Shqiptare, me resurse të jashtëzakonshme turistike, ku ka rritje të madhe të numurit të turistëve. Dallohet Thethi, Valbona, Vermoshi, Lëpusha, Curraj i Epërme, lumi i Shalës, Razma etj. Por ende nuk ka asnjë studim apo vlerësim mbi karakterin e turizmit që po aplikojmë, është ky masiv, spontan, kaotik, apo i studiuar, i kontrolluar dhe i qëndrueshëm? Cila është prirja, cilat janë pasojat në mjedisin natyror e social? Çfarë thotë përvoja e vendeve të tjera, që, si edhe ne, turizmin e kanë degë prioritare të ekonomisë së tyre?. Janë jo të pakta vendet në botë, që, të dehura nga euforia e rritjes së shpejtë të turizmit, i dhanë përparësi turizmit spontan, kaotik masiv. Nisur nga rritja e shpejtë e numrit të turistëve, ato u quajtën "meteorë". Por, si dhe meteorët, që shkëlqejnë në qiell vetëm disa sekonda, edhe në këto vende, shumë shpejt, turizmi masiv dëmtoi rëndë vlerat e peizazhit natyror e social dhe u braktisën nga turistët. Studiuesit kanë theksuar se turizmi është "thikë me dy presa"; se turizmi masiv, duke shkatërruar mjedisin natyror e social, "ha vetvehten". Po tek ne si qendron ky problem i madh? Duhet theksuar se përtej euforisë dhe politizimit të skajshëm, zhvillimi i turizmit, në vitet e fundit, ka nxjerrë nevojën urgjente të mbrojtjes së vendbanimeve, siteve të mbrojtura, peizazheve dhe mjedisit natyror e social nga valët e zhvillimit spontan, kaotik të turizmit masiv shumëmilionësh (shpejt 30 milion). Në referimet e mija në forume shkencore, por edhe në publikime kam theksuar se zhvillimi i vrullshëm, por kaotik i turizmit në Theth, dhe jo vetëm, është një "minë me sahat"; nuk do të jetë e largët dita kur kjo "minë" do të "shpërthejë" dhe Thethi, kjo perlë e rrallë, natyrore dhe sociale, si thekson studiuesi thethjan Florian Fusha, e kthyer në 20 vitet e fundit, në Bathore, në xhungël ndërtimesh, që kanë cenuar rëndë arkitekturën tradicionale, do të humbasë atraksionin e fuqishëm turistik. Zhvillimet e fundit tregojnë qartë se "mina" e Thethit shpërtheu, duke sjellë probleme të mëdha sociale, me pasoja të rënda për thethjanët, për qendrat e tjera turistike, por edhe për të ardhmen e turizmit, kësaj dege prioritare të ekonomisë sonë. Katrahura e ndërtimeve shprehet në stilet e ndryshme të ndërtesave turistike, nga vilat e reja me projekt gjerman, italian, zviceran apo austriak deri tek kontinierët e shëmtuar, nga ato me mure tulle tek ato me kontruksion metalik, druri, apo betoni. Jo vetëm kaq. Sipas studiuesit të cituar, janë ndryshuar kullat: duke u shtuar kate e zgjerime, janë ndryshuar dritaret karakteristike dhe çatitë e mbuluara me tjegulla e llamarinë të kuqe etj. Kur Gtz gjermane financoi zhvillimin e Thethit, në vitin 2004, theksoi se kurrsesi nuk duhet të preken nga jashtë kullat alpine të traditës, por vetëm të restaurohet brendësia e tyre, duke krijuar kushte optimale për turizmin. Gjithandej në Theth shikon ndërtime dy ose më shumë kate, me ballkone, të ndërtuara me tulla dhe të suvatuara, të mbuluar me llamarinë të kuqe apo ngjyrë tjetër, madje edhe me soletë. Arkitektura e tyre nuk ka asnjë element tradicional të kullës së famshme, por është njëjtë me ndërtimet në vendbanimet fushore apo kodrinore të vendit. Pse nuk mësohet nga njerëzit e mençur të fesë katolike, që rikonstruktuan kishën e Thethit, duke ruajtur tiparet e kullës? Shtoj se në afërsi të Vermoshit, tek Bashkimi, po ndërtohet një hotel i madh, dhjetëkatësh, me beton dhe arkitekturë "moderne". Duke braktisur ndërtimet tradicionale me gurë dhe çati druri tepër të pjerrët për të mos mbajtur dëborë dhe për t`iu përshtatur aq bukur natyrës së ashpër të peizazhit alpin, është cenuar rëndë një nga vlerat origjinale të traditës së arkitekturës së banesave, duke e unifikuar me qendrat turistike malore evropiane. Jo vetëm kaq. Ndërtimet e reja pa plan urbanistik, tepër të dendura, kanë krijuar një xhungël të vërtetë, ku po zhduken mjediset publike, rrugët, sipërfaqet e gjelbërta dhe kopshte e "qëndisura" me aq kujdes, si pjesë e pandarë e strukturës tradicionale urbane dhe e peizazhit alpin të Thethit. Në to merreshin prodhime bujqësore bio, aq të kërkuara nga tregu turistik. Kërkesat e këtij tregu, do t`i plotësojë fusha e Shkodrës, Myzeqeja apo importi. Ky është dhunim ekstrem i ligjit për zonat e mbrojtura, i historisë dhe i peizazhit magjepsës alpin; i turizmit të kultivuar në vite me sakrifica për ta bërë Thethin destinacionin turistik më të kërkuar. Thethi është dy herë i mbrojtur me ligj: Park Kombëtar dhe Qendër e Mbrojtur Historike. Sipas ligjit të tyre, nuk lejohen ndryshimet e traditës; çdo ndërhyrje duhet të jetë e kujdesshme, e studiuar, me lejë dhe nën kontrollin e Institutit të Monumenteve. Aty duhet të ndalohet çdo ndërtim tjetër,



përveç kullës tipike alpine thethnjane. Kujtoj se Thethi, para disa viteve, u përfshi në projektin e madh kombëtar të 100 fshatrave. Më gjithë objektin vizionar - studimin dhe ndërtimin e programeve të zhvillimit të shpejtë, të qëndrueshëm e në harmoni me natyrën, si modele zhvillimi të vendbanimeve rurale - ky projekt pati jo pak probleme, që lidheshin me konceptimin e ngushtë të objektit dhe të specialitetit të autorëve, kryesisht urbanistë e arkitektë. Pa mohuar aspak rolin e madh të tyre, ka qenë e mbetet e domosdoshme, pjesëmarrja edhe studiuesve të tjerë. Edhe për Thethin, si për të gjitha fshatrat e tjera, projekti përgatiti planin rregullues të territorit për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit. Për fat të keq, këto modele tashmë janë harruar. Ku shkoi gjithë ajo punë, ku shkuan gjithë ato lekë të konsumuara nga ky projekt? Kush mban përgjegjësi për këtë investim? Moszbatimi i këtij projekti, ishte një nga shkaqet e krizës së fundit në Theth, në qendrat e tjera turistike, madje edhe të krizës që kërcënon të ardhmen jo të largët të turizmit tonë. Si po mbrohen vendet e tjera nga valët shkatërruese të turizmit masiv? Natyrisht, problemet e mëdha natyrore e sociale të turizmit masiv ka kohë që janë shfaqur në shumë vende të botës. Studiuesit e disa fushave, duke dhënë alarmin për këtë rrezik, përpunuan metoda shkencore për të matur saktë aftësinë mbajtëse të ngarkesës turistike të peizazheve natyrore e sociale. Mbi këtë bazë, duke vlerësuar resurset turistike, llojin e turizmit më të mirë, infrastrukturën turistike, burimet mbështetëse, numrin e llojin e turistëve, që mund mbajë pa probleme peizazhi natyror e social, propozuan strategji zhvillimore të turizmit të qëndrueshëm Njihen rastet e kufizimit të numurit të turistëve: për të vizituar disa site të mbrojtura të ishujve të famshme Galapagos (trashëgimi botërore), duhet të shënosh emrin qysh në një janar; Italia, për të ulur mbipopullimin e siteve të njohura, vendosi kontrollin e numrit të turisteve, deri 1,100 turistë në ditë, që e rezervojnë vizitën e plazheve të Sardenjës; Spanja, duke kufizuar numrin e turistëve dhe kontrolluar sjelljet problematike të turistëve etj, jep modelin e balancimit të zhvillimit turistik me mbrojtjen e vlerave natyrore e të jetës së banorëve; Ministria për Turizmin e Kulturën e Irlandës ka ngritur Observatorin e Turizmit të Qëndrueshëm, i cili mat dhe monitoron ndikimin ekonomik, mjedisor e social të turizmit. Mbi këto matje bazohen politikat qeveritare e vendimmarrja private, që sigurojnë rritje të qëndrueshme dhe elastike të turizmit. Po tek ne? Problemet janë të shumta, pa pretenduar për t`i trajtuar të gjitha, po ndalem vetëm në ato që lidhen me urgjencë studimeve shkencore, të cilat të paraprijnë e mbështetin strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit. Ftoj të gjithë studiuesit të japin ndihmesën e tyre në zgjidhjen e këtij problemi të madh, kompleks dhe me shumë të panjohura. Po theksoj vetëm disa drejtime, që ndihmojnë në zgjidhje afatshkurtra e afatgjata për Thethin dhe për gjithë vendin. - Politika duhet të zgjidhë sa më parë dhe me drejtësi pronësinë e tokës, duke çertifikuar pronarin e ligjshëm dhe të lehtësojë procedurat për lejet e ndërtimit. Kjo do të evitonte konfliktet midis shtetit dhe banorëve, do t'i çojë gjithë njerëzit drejt ligjshmërisë, duke krijuar bindjen se konfliktet nuk zgjidhen me thirrje nxitëse për përdorim force nga bajraktarët e tre shekujve më parë apo të priftërinjve, që kanë harruar funksionin fisnik të fesë. - Duhet të studiohen prirjet e sotme të investimeve drejt infrastrukturës gjigande turistike me stile arkitekturore, që thyejnë traditën tonë, nxisin turizmin masiv, duke krijuar mbingarkesë të madhe turistike, që shkatërron peizazhet natyrore e sociale, vrasin turizmin. Po sjell rastin e Voskopojës, ku krahas ndërtimeve karakteristike me gur, rrugëve me kalldrëm karakteristik dhe hoteleve të vegjël, deri në dhjetë dhoma, rritja e kërkesave të turizmit, po imponon ndërtimin e hoteleve të mëdha, me beton e arkitekturë "moderne", që cenojnë rëndë traditën voskopojare. - Për të kapur kohën e humbur dhe për të mos u përplasur me të papritura të hidhura, duhet të ndërmerren urgjentisht studime të thelluara shkencore mbi kapacitetet mbajtëse turistike të peizazhit natyror dhe social të qendrave turistike. Këto studime janë plotësisht të mundshme, sepse institucionet shkencore, si: Njësia kërkimore gjeografike e Akademisë së Shkencave, departamentet e gjeografisë në disa universitete të vendit dhe të afërta me gjeografinë etj kanë kapacitetet e duhura shkencore për të realizuar studimin e aftësive mbajtëse të ngarkesës turistike nga peizazhet natyrore e sociale. Mbi bazën e këtij studimi të ndërtohen strategji dhe programe zhvillimore të turizmit të qëndrueshëm, për ne dhe brezat e ardhshme. Kjo do të vinte në kontroll valët e turizmit spontan masiv, do të mbronte traditën dhe mjedisin natyror e social. Do të duheshin dekada për rikuperimin e pasojave të zhvillimit mbi kapacitetet turistike. Vetëm turizmi i kontrolluar, deri në aftësitë mbajtëse të peizazheve natyrore e sociale, siguron zhvillim të shpejtë e të qëndrueshëm social dhe ekonomik. - Njëherazi, duhet të studiojmë asete të tjera turistike dhe të menaxhohen ato shkencërisht. Kjo, veç të tjerave, do ta shtrinte zhvillimin, përmes turizmit miqësor me mjedisin natyror e social, në gjithë territorin e vendit, duke lehtësuar zonat e mbingarkuara nga turizmi masiv dhe duke e shpëtuar peizazhin e tyre nga shkatërrimi i sigurte. - Të kryhen studime të integruara dhe komplekse të trashëgimisë natyrore e kulturore të qendrave turistike. Kjo krijon kushte për ndërgjegjësim për vlerat e trashëgimisë sonë, si hapi i parë drejt mbrojtjes së tyre; për ta konsideruar këtë trashëgimi si burim e bazë për strategji zhvillimi të të turizmit të qëndrueshëm e miqësor me mjedisin; për vendosjen e bashkëveprimit pozitiv midis njeriut dhe mjedisit, midis natyrës e kulturës, midis nevojave ekonomike dhe mbrojtëse të kësaj trashëgimie dhe mjedisit; për të zëvendësuar qasjen e vjetruar që e sheh mbrojtjen ligjore dhe programet e e kësaj mbrojtjeje si pengesë dhe jo si mundësi zhvillimi; ka dështuar koncepti se zonat e mbrojtura duhet të sigurojnë vetëm të ardhura. Sipas vizionit të ri evropian, zonat e mbrojtura në radhë të parë, kanë lindur si domosdoshmëri për të ruajtur vlerat natyrore e kulturore, cilësitë e tyre etike dhe estetike, si nevojë për rekreacion në një mjedis, ku njeriu të jetojë me dinjitet dhe i shëndetshëm. Njëherazi ato kanë lindur për të formësuar, ruajtur e përcjellë në breza identitetin natyror e kulturor, që përbën themelin e koherencës regjionale e kombëtare, të përkatësisë dhe indetitetin rajonal e kombëtar të shqiptarëve. Thethjanët e investitorët e tjerë të sensibilizohen për respektimin e ligjeve të Parkut Kombëtar e Qendrës së Mbrojtur Historike. - Urgjentisht të përgatiten planet urbanistike të konsoliduara për qendrat turistike dhe kodet e urbanistikë, ku të jepet ku dhe çfarë të ndërtohet; artitektura sipas traditës historike, peizazhit natyror e social; të zgjidhen problemet arkitekturës së peizazhit, duke treguar ku duhet të lihen rrugët, ndërtesat e fshatit, objektet turistike, të cilat të ndërtohen vetëm pas ndërtimit të infrastrukturës bazë: ujë, energji, kanalizime, rrugë, shërbime dhe mbrojtje mjedisore. Së fundi, edhe një herë theksoj se zgjidhja e këtyre problemeve të mëdha kërkon ndihmesën e studimeve të thelluara nga disa shkenca natyrore, gjeografike, sociale, ekonomike, politike etj. Këto studime të përbashkëta do të siguronin mbështetjen shkencore të menaxhimit territorial, mjedisor, demografik e zhvillimor; do të ndihmonin ndërtimin e strategjive dhe programeve për zhvillimin e qendrueshëm të turizmit.

Me 18 korrik 2026





Në Sofren Pukjane, 2026

Ma daten 3 tetor 2026 në qytetin e Pukës, "u shtrua" per te 18 -tin vit Sofra Pukjane. Sheshi Skenderbeu dhe Pallati i Kultures "Ndue Shyti" ishin mjediset ku u mblodhen banoret vendor, miqte dhe te ftuar nga zona te ndryshme te vendit. Eshte kjo nje veprimtari e perviteshme qe organizohet dhe sponsorizohet nga grupimi I biznesmenve pukjane. Ne ate dite u zhvilluan disa veprimtari te programuara Takime te ndryshme te banoreve me biznesmenet, koncert nga dy Qendrat kulturore te Femijeve Puke e Fushe-Arrez, Koncert festiv nga kengetaret dhe valltaret pukjane dhe jo vetem. Veprimtaria u mbyll me nje dreke festive.

Fjala pershendetese e Presidentit të "Sofrës Pukjane" Tonin Alia (Mjeshtri I Madh)

Përshëndetje të gjithëve!

I nderuar Zv. Kryetar i Bashkisë Pukë, Z.Ferit Rringa. I nderuar Kryetari I bashkisë Fushë-Arrëz Z.Hil Curri

E nderuar Prefekte e Qarkut Shkodër, znj.Dr Holta Dudo e Zv.prefekte Amila Gjyrezi .

Të nderuar deputetë e ish deputet të Kuvendit të Shqipërisë, z. Arjan Ndoja, Z.Shkurt Lasku, Z.Frrok Gjini, Z.Lodovik Hasani.

Të nderuar Kryetari I komunes Z.Giampiero Foosi. Të nderuar kordinatorë të binjakëzimit B.Puke me komunën e Signa, Z.Nikolin Gjeloshi.

I nderuar Z.Marin Perkeci, përfaqësues I Sofrës Pukjane në Amerikë

Të nderuar anëtarë të grupit organizator dhe sponsorizues të "Sofrës Pukjane",

Të nderuar pjesëmarrës, miq e dashamirës,

Mirë se erdhët në edicionin e 18-të të "Sofrës Pukjane"! Është një kënaqësi dhe një nder i veçantë që edhe këtë vit mblidhemi së bashku rreth kësaj sofre, e cila prej gati dy dekadash është bërë simbol i bashkimit, i dashurisë për vendlindjen, i kulturës, traditës, bujarisë dhe mikpritjes pukjane.

Puka është një trevë e veçantë shqiptare, e vendosur në një terren malor, me pyje të dendura, male, liqene e lumenj dhe me peizazhe të bukura, që krijojnë mundësi të mëdha për zhvillimin e Turizmit.

Ajo është e pasur me burime natyrore, minerale, si bakër, krom e kaolinë, ndërsa lumenjtë dhe liqenet e saj kanë krijuar mundësi të rëndësishme për zhvillimin energjitik dhe ekonomik të zonës.

Përtej çdo pasurie natyrore, pasuria më e madhe e Pukës janë njerëzit që kanë lindur, jetojnë , punojnë e kontribojnë për vendëlindjen e tyre.

Pas ndryshimeve demografike të viteve '90, shumë vëllezër e motra pukjanë u larguan nga vendlindja, brenda dhe jashtë Shqipërisë, në kërkim të një jete më të mirë.

Por largimi nuk do të thotë kurrë harrim e mosëkthimë për pukjanët, kudo që shkuan, morën me vete kujtimet e vendlindjes, dashurinë për familjen, traditat, bujarinë, fisnikërinë e mbi të gjitha, mikëpritjen.

Këto vlera u ruajtën, u promovuan dhe u përcollën brez pas brezi edhe nëpërmjet "Sofrës Pukjane", e cila sot është kthyer në një institucion të rëndësishëm të bashkimit të pukjanëve kudo që ndodhen brenda e jashtë vendit. Sofra jonë nuk është vetëm një tryezë ku mblidhemi, por eshtë një urë që lidhë të shkuarën me të ardhmen.

Puka ka një trashëgimi të jashtëzakonshme natyrore e kulturore dhe duhet të jetë një burim krenarie për çdo pukjanë. Ne duam që brezat e rinj ta shohin Pukën jo vetëm me nostalgji, por edhe me besim e vision, dëshirë për ta zhvilluar promovuar e lulëzuar në cdo stinë të vitit.

E ardhmja e saj duhet të ndërtohet mbi pasuritë natyrore, kulturën, traditat, turizmin, sipërmarrjen dhe, mbi të gjitha, mbi njerëzit e shkëqyer që e duan dhe e mbajnë gjallë këtë trevë.

Gjatë këtyre 18 viteve, "Sofra Pukjane" është përpjekur të ketë në vëmendje zhvillimin e kulturës, mbështetjen e talenteve të reja, artistëve e sportistëve të afirmuar.

Kemi mbështetur Ditën e Kulturës Pukjane, në ditëlindjen e artistit të popullit Z.Ndue Shyti, festivalin Mbarëkombëtar të Fëmijëve FushëArrëz e Pukë, si dhe veprimtarinë të ndryshme. Kemi bashkëpunuar dhe kontribuar, me aq sa kemi mundur, edhe për bashkësitë fetare në rrethin e Pukës.

Këte vit forcat i kemi përkushtuar për kthimin në identitet të Kishës së Shën Palit në Kabash, po punohet për dokumentacionin dhe miratimin në Ministrinë e Kulturës meqënse është objekt i trashgimisë kulturore i kategorisë së parë shpallur në vitin 1984. Fondet për fillimin e punimeve nuk mungojnë por dokumentacioni kërkon kohën e vetë. Kemi qenë të gatshëm të ndihmojmë në përballimin e fatkeqësive natyrore dhe situatave të vështira shëndetësore e sociale. Këto janë dëshmi se "Sofra Pukjane" nuk është thjesht një veprimtari festive. Ajo është një frymë bashkimi dhe një përgjegjësi ndaj vendlindjes.

Puka ka pasuri natyrore dhe njerëzore të cmuar e vlerësuara kudo, është cilësuar nga vendas dhe të huaj si një parajsë natyrore. Ajo është e veshur me pyje pishe, ahu, bredhi, geshtenje , panje, frashëri, blini, shkozë , dhe drurë të rrallë mjaft të cmuar. Malet e larta si Munella, Krrabi, Kunorë Dardha e Tërbuni janë një nga pasurit më të cmuara natyrore të zonës dhe streha e një faune të pasur, ku përfshihen rrëqebulli, ariu, ujku, macja e eger, kaprolli, dhelpra, derri i egër, lepuri e shqiponja.

Rrugët që përshkojnë trevën, shtigjet turistike, liqenet, lumenjtë, bujtinat, fshatrat, kulinaria tradicionale dhe mikpritja pukjane krijojnë një mozaik vlerash që duhet ta promovojmë edhe më shumë.

Vitet e fundit, vilat, bujtinat, restorantet dhe strukturat e reja turistike të ngritura nëpër fshatra, flasin për një cilësi të re jete dhe, për një rikthim të banorëve në trojet e të parëve.

Ky është një zhvillim që duhet mbështetur, nxitur dhe promovuar fort nga të gjithë aktorët që e njohin Pukën brenda dhe jashtë vendit. Nga anëtarët e "Sofrës Pukjane" janë ndërtuar dhe rikonstruktuar shtëpi, restorante e hotele në zona të ndryshme të Pukës, është negociaur vazhdimisht në të gjitha instancat e larta të shtetit për zhvillimin e Pukës .

Këto investime janë një tjetër dëshmi se pukjanët, edhe kur jetojnë larg, vazhdojnë të besojnë dhe të investojnë në vendlindjen e tyre. Mirënjohje për institucionet dhe kontribuesit.

Mirënjohje për Komunen e Signa Itali që shpehu dëshiren për të kontribuar në zhvillimin e Bashkisë Pukë. Në këtë ditë, dëshirojmë të falenderojmë Prefekturen e Qarkut Shkodër, Bashkinë Pukë dhe Bashkinë Fushë-Arrëz, të cilat punojnë për zhvillimin dhe rritjen e vlerave të kësaj treve.

Mirënjohje për Sofrën Pukjane në Amerikë me përfaqsues Z.Marin Përkeci. Mirënjohje për Klubin e Shkrimtarëve dhe Artistëve, Shoqatën Ekoturistike, për kontributin e tyre në kulturë, art dhe turizëm.

Sot është rasti të shprehim respektin dhe mirënjohjen tonë të sinqertë për ekipin e biznesmenëve pukjanë që nuk kursejnë asgjë për zhvillimin e vendlindjes së tyre.

Mirënjohje për: Tonin Alia, Rrok Gjoka, Mark Gjinaj, Arjan Ndoja, Ndoc Mustafa, Lazër Mhilli, Lush Osmani, Ded Maluta, Petrit Syla, Mark Luli, Pashk Rrapi, Andrea Zaja, Agim Kola, Pal Cara, Vasil Muslia, Mark Frroku, Ilir Ibraj, Shkurt Lasku, Alban Papushi, Ndue Shani, Nikolin Qafa dhe Roldi Deda. *Secili prej tyre, në mënyrën më të mire të mundshme , është pjesë e një kontributi të përbashkët për Pukën. Një sofër që gjithmonë na bashkon,*

"Sofra Pukjane" është shtëpia jonë e përbashkët. Është vendi ku takohemi, kujtojmë të parët tanë, ruajmë traditat, ndajmë mendime dhe ndërtojmë ide për të ardhmen.

Kjo sofër na ka bërë të kuptojmë se, pavarësisht se ku jetojmë, vendlindja na bashkon dhe na thërret gjithmonë pranë saj.

Sot, në edicionin e 18-të, ne nuk festojmë vetëm një traditë që ka zgjatur 18 vite dhe te mos ndalet per te vijuar ne shume vit te tjera. Ne festojmë për Pukën, pukjanët dhe lidhjen e tyre të përjetshme me vendlindjen. Le ta ruajmë këtë traditë dhe t'ua përcjellim brezave. Le t'u mësojmë fëmijëve tanë se vendlindja nuk është vetëm një vend në hartë por është vendi ku duhet të kontribojmë e ta mbajmë traditen sic e ka zakon Pukjan.

Vendlindja është kujtesë, identitet, kulturë, familje, rrënjë dhe pjesë e pandarë e jona. Prandaj, le të punojmë së bashku që Puka të jetë gjithnjë e më e zhvilluar, më e dashur për banorët e saj dhe për të gjithë ata që e vizitojnë. Le të vazhdojmë ta mbajmë të shtruar këtë sofër, jo vetëm për të kujtuar të kaluarën, por edhe për të ndërtuar të ardhmen.



Dhe le të jetë kjo sofër gjithmonë një vend ku pukjanët takohen si miq, vëllezër, motra dhe si një familje e madhe. Me këtë frymë, ju uroj të gjithëve mirë se erdhët, gëzuar dhe një veprimtari sa më të bukur e të suksesshme!

Uroj që kjo sofër të mbetet gjithmonë e shtruar për miqësinë shoqërinë, bashkimin, kulturën, traditën dhe dashurinë për Pukën. Faleminderit të gjithëve dhe suksese në veprimtaritë e ardhshme!

Nga grupi organizator u be nje vizite ne "Pushimoren Fotosinteza"

Pergatiti per botim:
Gjon Fierza

Kërcimtarja e Dukagjinit

Nga Ernest Koliqi

Puc, motër e vogël andërrtare qi hapë sytë e zez të mëdhaj edhe dridhesh nga andja e sendeve të mrekullueshme kur të kallzoj ndonji prrallë, – Puc, shtegtare e palodhshme gjatë udhës lulëzim-plote të prrallave, e cila në këtë jetë a' ndoshta e vetmja qi arrin deri tu Fatbardhësija, – Puc, ndëgjoje, me kureshtën e heshtëshme qi të pezullon krejt gjallninë e vizave të fytyrës e të gjymtyrve të njoma, legendën e vjetër të Kërcimtares së Dukagjinit.

Paska qenë dikur në Dukagjin nji vajzë mrekullisht e hijëshme. Për në dhe' tonë asokohe mund të thohej se nuk kishte si m'u gjetë nji tjetër ma e bukur. Hijeshija e fytyrës e përsosja e gjithë pjesëve të trupit, lente për nji copë herë pa mend para saj kedo qi e shifte së pari. Kryet, krye perëndeshe; duert, duer Zanash; kambët aq të vogla e të lehta sa me t'u ba se he he po qesin fletë e po e çojnë fluturim n'ajri. Me dy fjalë: nji kryevepër natyre.

Por…

Kapricet e nanës Natyrë janë vërte të çuditshme. Vasha ma e bukur e dheut tonë ishte e ngathtë, e trashë, turulluqe. Kur flente dukej nji hyjneshë e zbritun nga qielli qi nji gjumë i papritun kishte zanë mbi tokë; sa zgjohej therte shpirtin me ngutinë e lëvizjeve, me pazhdërvjelltinë e sjelljeve e të gesteve e me trashamaninë e fjalëve. E gjithë ajo bukuri qi kishte derdhë Perëndija në te bante me spikatë edhe ma tepër shëmtimin e atyne mënyrëve të palëvrueta. Sytë lëshojshin shikime të fikuna, buzët iu shtrembnojshin në nji nenqeshje të marrë e të pakuptueshme. S'dinte me ndejë, s'dinte me ecë. Gjithë ditën e lume shifej me duer n'ijë pse kurrgja s'i vinte për dore me punue. Ishte mbesë e Lekë Dukagjinit. E ama ankohej me të gjithë për at kryq qi iu donte me bartun. Tashti ndodhi qi Mbreti i Shqiptarëve, Skanderbegu, mbas nji lufte të fitueme kundra tyrqve, grishi në Krue gjithë Parësinë e Shqipnisë për me kremtue at ngadhënjim armësh. Lekë Dukagjini ishte i thirrun ndër ma të parët e prandej shenjoi gjinden qi do ta përsillte: pesëdhetë luftarë të zgjedhun, njizet krenë, tridhetë gra e vajza ma fisniket ku ishin. Ndërmjet tjerëve i tokoi me marrë pjesë n'at udhëtim edhe Zogës me të bijën Lulen (kështu quhej vasha e çuditshme). Princeshë Zoga tue pregatitë petkat ma të çmueshme qi ruente n'arkët e mëdha, si për vete ashtu edhe për vajzë, fshante e shkreta, trishtueshëm. Mendja e saj s'kishte paqë. Mendonte se n'at mbledhje princash e bujarësh, bukurija e së bijës do të tërhiqte menjiherë vërejtjen e përgjithëshme e se shumë kush do t'i afrohej me andje për m'u largue i neveritun. Zbardhi dita e të nisunit. Kualt pritshin para kështjellit të Dukagjinve tue rrahë kalldramin me thundra të padurimshme, tue tërfatë e tue hingëllue. Kumbonët bijshin hareshëm për me i urue udhën e mbarë princit e ndjekësve të tij. Lekë Dukagjini doli, i rrethuem prej krenve, kërceu mbi kalë e u nis në krye të vargut. Parzmoret hekuri të burrave shkëlqejshin në dritën e diellit të mëngjesit. Veshat e grave e të vajzave hidhshin ngjyrat e ylberta nëpër blerimet e shtigjeve prendverore. U nisën, mbi kual, së bashku, rrethue prej heshtave të luftarëve përsjellës. Princeshë Lulja kishte hypë mbi nji kalë pullumb e ecte krah për krah me t'amën, pa folë. Zoga bisedonte pa pushue me gra. Tue



e dijtë se Lulja nuk i qëndronte mirë kalit, or' e ças sillej për me i thanë: "Venja menden se këtu rruga asht e keqe". Por nji herë tue u dredhë me ia përsëritë për të dhetën herë këtë porosi, çudija e la me gojë haptë. E bija e shikonte me dy sy të qeshun, plot gjallëni e ambëlsi qi i jepshin fytyrës nji shkëlqim të jashtëzakonshëm. Zoga rrahi qerpikët e vërejti ma mirë. N'at buzëqeshje hyjnore skajet e buzëve nuk iu ulshin tue iu shtrembnue si në ditë tjera. Mbandej i rrinte kalit për bukuri si kalorset e vadituna qi gjajnë të leme mbi te. Por çudija e Zogës dhe e gjithë udhëtarve gjet kulmin kur karvani doli në nji shesh të gjanë e Lulja e lëshoi kalin në pikë të vrapit, bashkë me djelm qi dojshin me mujtë shoqishoqin në të ngamë, e arrijti e para tue kapërcye gropa e prroska me nji udobi të mrekullueshme. Ishte ndërrue krejt. Krijesë ma të shkathtë s'kish pae sy njeriu. Nuk e zente vendi vend: herë dilte në krye të vargut tue u vërvitë tërmaleve të thikëshme, herë ndalej në fund për me zanë pastaj karvanin me vrape të falisuna: bante hoka, shpërthente në gaz të kandshëm e të zashëm nëpër varg t'udhëtarve tue zgjue ndjesi të freskta ambëlsije të mbinatyrshme. E gjithëkush bahej copash për ta kondendue në çdo trillë qi i kërcente. Zoga dyshonte mos ish n'andërr. Tue e shikue mirë s'i dukej bija e saj: fytyra po; edhe trupi po; sytë, por, si mos me qenë të Lules. Dy sy të rij, të panjohun, plot shkëndija misterioze qi mezi me ia durue të shikuemit.

Mbas nji udhëtimi tri ditësh me ndalje e pushime të shpeshta, princ Lekë Dukagjini e përsjellsit e tij arrijtën në Krue ku ishte mbledhë Parësija e gjithë Shqipnisë. Kishin ardhë tu Mbreti me dhunti të panjehuna edhe bajlozat e Venedikut, të Raguzës e të Mbret Alfonsit. Hareja ishte e shkrueme në gjithë fytyrat. Kanga kriste anë për anë. Vallet e lojnat derdheshin prej qytetit nëpër rrethe. Edhe qielli qeshej mbi at triumf lavdije shqiptare. Lulet e prendverës kruetane erësojshin mbi parzmat e gocave e të zojave t'ardhuna në kremtim nga katër anët e dheut të shqipeve.

Ishte agimi i ditës ma fatlume të kombit tonë, i asaj dite qi mbaroi tepër shpejt me nji perëndim të përgjakun tue lanë mbrapa natën e errtë të nji robnije shekujsh. Kremtimi i madhnueshëm ngjati shtatë ditë e shtatë net. Në pallat mbretnuer sofrat u shtrojshin njana mbas tjetrës e kush do, i njohun a i panjohun, shqiptar a i huej, mund t'u ulte në to. Muziktarë Italije, natën e ditën, mbajshin gjallë me vegla të tyne kangët e vallet. Kërcehej ndër sallone të ndritëshme të kështjelleve, ndër shtëpija të bujarëve, në çardaqe të pasanikëve, n'odat e pastolisuna të punëtorve, në jerevitë e skamnorve, nëpër lulishta e oborre, në rrugë të madhe. Gëzimi rrëmbente gjithkend sikur she i turrshëm qi bjen nga malet e hjedhta në fushë tue përla ça gjen përpara.

Ishte nji të marrun fryme ndërmjet dy luftimeve titanike. Mbreti i papërulun hiqte parzmoren hekuri e veshte në vend të saj petkun e mëndafshtë të pushimit për me i çelë popullit luftar kremtet e meritueme, të cilat shpesh herë ishin të këputuna në gjymsë nga nji kushtrim i ri.

Ditën e fundme të kremtimit, kasnecat mbi kual tue u fry burijave e tue u ra trumbetave nëpër sheshe e kudo qi daheshin udhët kryq, leçitën:

"Mbreti lajmon se ka me i falë plaçkën ma të çmueshme, qi u gjet në shatorren e krye-kumandarit tyrk të vramë, asaj vajze a grueje qi para oborrit mbretnuer të bajë kërcimin ma të bukur".

Nji grue e panjoun, veshë si tyrkinë, e mbështjellun krejt në mahrama të qindisuna qi ia mëshefshin fytyrën e trupin, erdhi e para. Mbreti ishte në sallën e madhe të kështjellit rrethue prej kapidanave ma të përmendun e prej bajlozave të huej. Rrinte në kambë, në mes të tyne, tue u sjellë fjalën tash njanit e tash tjetrit. Prej nji selije të naltë, Donika, mbretnesha e bukur e zemër-bardhë, i falte kujdo qi ta shikonte nga nji nenqeshje plot dritë e mirësi.

Sa muer vesht Mbreti për tyrkinën qi pritte jashtë, dha urdhën qi të niste menjiherë kërcimi.

Mbëkambësit sollën nji shtrojë të mëndafshtë Persije dhe e shpalisën tue mbulue me te mesin e sallonit. Oborrtarët u renduen rreth e rreth.

Tyrkina hyni, u përkul deri në tokë para Skandërbegut e u zbulue, tue hjedhë në nji anë mahramat e pashmangët ari qi kishte në kambë.

U kallzoi muziktarve jonën qi i lypej e, kambë-dathun, befas si ta prekte nji dorë e padukshme, u ngrit maje gishtave, çoi të dyja duert përpjetë e i ngjiti përmbi krye dhe u rrotullue kadalë me bel, tue i shikue të gjithë ndër sy sikurse të donte me njohun këqyrsit nji nga nji.

Shtat-hjedhun, me krahnuer të mbërthyem për gjymsash në nji xhamadan të shkurtë të ngrimun n'ar, këmishë harkate të ndërpashme, me mangë të gjana, dimij të hollë të mëndafshtë bojë qiell me lule të zbeta gjelbërore, lonte kambë e krahë ritmikisht herë shpejt herë kadalë. Nji unazë e vetme i ndritte në dorën e rrëmaktë me nji gur të madh qi qitte flakë në të luejtun. Dy vathë të gjatë iu varshin nga bulat e veshve.

Kërcimi i saj shëmbëllente nji lutje dashunore të dishprueme. Mësynte nji nga nji skajet e shtrojes tue përkulë belin e tue dredhë krahët pa pushue; zmbrapej me hove të shkurta; ravizonte rrotullakë të vetimshëm; ngitte maje gishtave me duer të ndeme si të kërkonte me zanë dashuninë qi ikë. Hapat e shpejtë e rrotullimi i krahve gjinikojshin nji vrellë përpise të luejtunash ku ajo dukej se don të fusë nji dashës të padukshëm. Por erdhi tue u ndalue, pak nga pak, deri sa kërcimi i saj u shëndrrue në nji ecje të kadalëshme: kryet e rrëzoi mbrapa si të lodhun; krahët përsollën me nji lëvizje shumë ma të qetë muzikën.

Mbet për pak çasa në mes të shtrojës si nji gem i lulëzuem qi flladi lëmon e puthë tue e përkulë kah të dojë. Por, qe, rishtas vallja e saj u ngjall, u valavit, flakëroi; ra, nisi prapë, vijoi me rrotullime të panjehuna, brodhi me hove të reja, u ba deshir pësim tërbim shpejtije, mbandej u ambëlsue, u zgjanue, mbaroi e kadalëshme e e plogët dhe në nji atitudë plastike gjet paqën.

Kur pushoi muzika, ajo ra ndër gjuj para Mbretit. Krahnori, tue marrë frymë, i rrihte me turr e sytë e zez të qeshun silleshin rrotull tue lëshue shikime përkëdhelse.

Mbas asaj u paraqit nji shkinë hollake e sy-larme e cila kërceu gëzueshëm e rrëmbyeshëm tue iu sjellë shtrojës për qark si çuterr gjarpnues qi përhapë fushave harenë e vet prendverore.

Pastaj tjera e tjera; u ndërruen ma se dhetë kërcimtare, disa t'ardhuna prej së jashtmi, disa të daluna nga vargu i madh i zojave e i zojushave bujare qi rrethojshin Mbretneshën.

E fundmja qe nji princeshë nga Tosknija qi bani nji kërcim të dridhshëm, plot hir e zhdërvjellti, buzëqeshun, sy-shkëlqyeme, rrethue me tanë dritën e rinisë së saj ngadhënjyese.

Si u këshillue me bajloza, Mbreti dau me ia dhanë çmimin e premtuem tyrkinës së panjohun e ishte kah jepte urdhën të shpallej ky vendim, kur nji kërcimtare e papritun e ndaloi tue dalë në mes të shtrojës.

Ishte princeshë Lulja, mbesa e Lekë Dukagjinit.

Si u ba ? Ça ndodhi ?

Porsa hyrija malsore çoi duert e luejti kambët, nji habi e ambël kapi gjithë shpirtnat. Nëpër tanë sallonin u ndie si nji amë lulesh mali e si nji gurgullim krojesh të ngrita.

Sy njeriu s'kishte pae as valle ma të mrekullueshme as kërcimtare ma të bukur. Lëkura e fytyrës së saj gjante e endun me rreze e fletëza prilli. Trupi i vërgjilët përhapte anë për anë nji njomësi si lule qi sa po ka çelë.

Të gjithëve iu bante se shifshin rreth saj tue lulëzue e tue u shfletëzue, si n'andërr, lulishta madhshtore. Ishte nji apotheozë lulesh: lule të denduna të panjehuna iu çelshin nen kambët e lehta, reshshin mbi flokë të lëshuem, dridhedhin ndërmjet gishtave të bardhë, derdheshin mbi trup hyjnuer.

Tash gjante si t'ish tue luejtë foshnjisht me përfytyrimin e saj në pasqyrën e nji uji të kulluet; mbandej dukej të këputte rremtha të lulëzuem, tue u ngritë maje gishtave të vogjël. Herë ngitte nëpër shtroje si të ndiqte ndonji flutur ari; herë valavitej si ta perkundte jehu i nji jonës së largët qi ngjallë malle të paprituna.

Merrte m'u ngjitun nëpër nji shkallë ajrore, largonte gjeth e lule të padukshme qi ia ndalojshin hovin, hidhej përpara si të biente zhyt në ndonji krue, shtrinte dorën me kapë shoqe tjera e sillej me mënyrën e asaj qi u prin nji vargu të gjatë vajzash kërcyese.

E drejtë si curril uji gufues, e lakueshme si gem i njomë, e shpejtë si hije reje, e dridhshme si drita në krue, endej shpejt, kadalë, hovshëm, pritueshëm. Kërcimi i saj ishte i freskët si lirija e maleve, i lehtë si kind flamuri qi valon ndër maje t'epra, i egër si fluturimi i shqipeve, i përmallshëm si kangë e harrueme qi ngjallet në fund të zemrës.

Sa mbaroi, nji brohori e përgjithshme e emnoi mbretneshë të kërcimtareve. Mbreti vetë erdhi m'e marrë për dore. Princat, kapidanat, bajlozat, bujarët, kalorsit e rrethuen tue e mbulue me lavde e tue i ngjitë mbiemna të bukur.

-Zanë me flatra !

-Hyjneshë e kërcimit !

-Dritë hane në prrue !

-Fllad fluturues !

-Lule n'erë ! Flutura e Shqipnisë !

Bajlozi i Venedikut i pështpëriti:

-Tersicore !

E ama, Zoga, me çudinë ma të madhe qi mund t'i shprehte fytyra, u lëshue kah ajo:

-Po kush të ka mësue, moj, ty me kërcye ashtu ?

Shatrat e Mbretit e çuen me zgjedhë ça të donte ndër plaçkat e luftës së fundme. E ajo mori nji peshtah ari të punuem për mrekulli.

Mbretnesha e thirri afër vetes dhe e puthi në ballë. Tuba lulesh të panjehun nisën me i ardhë. Princat e rij çojshin me kërkue lule nëpër lulishta të Krues për te; zojat i hiqshin prej parzmit me ia falë asaj.

Nji triumf i pashoq !

Ajo shkëlqente për gjithë ças ma e bukur ma e njomë, ma tërhjekse.

Festat mbaruen e gdhini dita e kthimit. Lekë Dukagjini me përsjellsa u nis për Malsi.

Udhës të gjithë ishin të lodhun prej kremtimeve të gjata. Vetëm Lulja, së cilës iu përtrijshin ças me ças forcat, s'kishte kurrë qeti. Lojnat e hokat e saj, gazi kristaluer, të ngamet mbë kual ngjallshin gëzimin e tretshin lodhjen e shtegtarve.

Arrijtën, tekembramja, në nji perëndim të kuq, te kështjelli i Dukagjinve. E, sa hangrën bukën, të gjithë u rrokullisën në të shtrueme me i hjekë spik gjumit.

Të nesërmen nji lajmtar i papritun e zgjoi heret Zogën. Lekë Dukagjini e thirrte për nji punë me randësi të madhe. Ia kish befë në kështjell nji princ i ri, nga shtëpija e Muzakajve, qi kërkonte m'e marrë Lulen e donte m'u fejue aty për aty. Kërcimi i pashoq e kishte ba m'u çmendë mbas saj, e ai kish vrapue për t'arrijtë i pari, sepse ishte i sigurtë se tjerë deshirtarë do t'u paraqitshin për së shpejti.

Zoga, si mori vesht punën, ngau me zgjue të bijën. Por kjo gërhitte tue fjetë e s'ishte send qi e lonte vendit.

Mbasi e shkundi e ama mirë e mirë, në fund Lulja u ngrit me sy të turbullt e me nji shprehje mërzije në skaje të buzëve.

-Çou, -i briti Zoga, -se kanë ardhë me të lypë për grue.

Ajo s'u tund asnji fije, por mori m'u veshë kadalë me plogëtinë e zakonshme.

-Ma shpejt, he qyqe ! Ku ma lae zhdërvjelltinë qi kishe në kërcim ? -bani e ama tue e nxitë.

-Ku ? Si ? -pyeti vajza e nji habi e madhe iu pikësue në fytyrë.

-Në Krue, pra deh, -ia priti Zoga: -kur ishim në Krue.

Vajza qeshi si e marrë e tha:

-Në Krue ?… Po unë s'jam kenë kurrë në Krue !

E ama e vërejti çuditshëm. Sytë e Lules kishin shikimin e dekun të përparandejshëm; buzët iu shtrembnojshin prapë në nji nenqeshje trashanike e të pakuptueshme.

E, si Zoga, të gjithë u habitën, kur e panë Lulen të kthyeme përsëri në plogëtinë e trashamaninë e dikurshme. Askush nuk mund të kuptonte se si ajo vajzë e ngathtë kish pasë nji triumf aq të madh në Krue. Por çudija kapërcente gjithë kufijtë e kuptimit kur ajo bante be se kurrë s'mbante mend qi të kish kërcye në jetën e vet. Princi i ri, sa e soditi dhe foli pak me te, lypi leje e iku i dishpruem.

Puc, motër e vocërr me shpirt plot et mrekullimi, unë e shof në buzët e tuja të njoma tue u ravizue pyetjen qi rrjedh vetvetiu mbas këtij kallzimi.

"Ça kishte ndodhë ?"

Mos i hap sytë e bukur edhe ma tepër se i ke hapë; qe, me dy fjalë po ta hjeki kureshtën. Zanat e Dukagjinit, për me i qitë zanin maleve të tyne, kishin da qi njana prej sosh të merrte fytyrën e trupin e Lules e të shkonte në Krue në vend të saj, më sa qi këte, tue e plandosë në nji gjumë të randë, e kishin vu me fjetë në banën hyjnore ku ato jetojnë. Mbandej e kishin çue prapë në shtëpi, natën, pranë s'amës, kur shoqja e tyne ktheu nga triumfet e Krues. Puc, Zanat bajnë shpesh këso lojnash!…

QIELLI I DJALËRISË

Qielli i djalërisë në sqep të një zogu
Ra mbi korijen me përralla;
Nga kashta e kumtrit bie dhe bie
Tërfili i artë i qiejve.
Këmbanat e yjeve lëkunden me hare
Prerë nga hëna e majit.
Qielli i djalërisë në sqep të një zogu
U zhduk pas portës së ylberëve.
Zhduket pas portës së ngjyrave djalëria
Dhe mua trishtimi më mbulon
Nën një hënë që nuk di të buzëqeshë,
Në një botë qe nuk më kupton.

POETI NË SHKRETËTIRË

Absurditetet pa asnjë mesazh për TV-të e botës.
Rrallë ndonjë re, arratisur nga kopeja e reve
Ikën e hutuar nga peizazhi arabik.
Ai rri aty me kokën në duart e shkretirës.
U bënë me dorë avionëve.
Pret një dallëndyshe që s'ka për të ardhur kurrë.

Dashuri e humbur

Dola nga guernika e kësaj nate
I vrarë egërsisht,
Kali i zi i pikëllimit
Në shtegun e vjetër më priste.
Kali i zi i pikellimit ç'më rrëzoi
Dhe rashë si në ballada;
Gdhendur në gravurat e vjetra,
Përmbys mbi shqytin e natës.
I vrarë nga një pranverë e kotë,
Braktisur nga bota e tërë,
Vetëm kali i zi i pikëllimit vjen rrotull
Dhe qan për të zotin e vjetër.

PËRGJITHMONË

O ajr i mbrëmjes mbështillme, erdhi ora të vdes përsëri.
Kur të mbyllen sytë e mi, nuk do të ketë më det
Dhe varkat e lotëve kanë për të ngecur në sterë.
Shkoj dhe shirat po i lë të kyçura
Por do të kthehem përsëri në çdo stinë që të dua.
Une kam qenë trishtimi i botës.
O ajr i mbrëmjes mbështillmë, erdhi ora të vdes përsëri.



Frederik Rreshpja

REDAKSIA
Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri, Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

MUNDËSOI BOTIMIN GJELOSH PJOLLA

